

2011

**RAPORTI VJETOR
KOMISIONERI PËR
MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**



PËRMBAJTJA

FJALA HYRËSE E KOMISIONERIT.

I. MISIONI I KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PËR VITIN 2011.

II. NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM PËR VITIN 2011.

III. SENSIBILIZIMI DHE REGJISTRIMI I KONTROLLUESVE.

III.I Aktivitete sensibilizuese.

III.II Njoftimi i subjekteve kontrollues.

III.III Menaxhimi i njoftimeve dhe regjistrimi i subjekteve kontrollues.

IV. ZHVILLIMET DHE PËRMIRËSIMET NË KUADRIN RREGULLATOR LIGJOR.

IV.I Udhëzime

IV.II Dhënie mendimi

IV.III Propozimet kryesore në Amendimet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, gjatë vitit 2011.

IV.IV Transferimi nderkombëtar.

IV.V Marrëdhënie institucionale me institucione të tjera.

IV.VI Përkthime.

V. PROCESI I INSPEKTIMIT

V.I Trajtimi i Ankesave.

V.II Kontrolli dhe Inspektimi Administrativ.

V.III Masat Administrative – Gjobat.

VI. BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL DHE MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE PËR KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

VI.I Marrëveshje bashkëpunimi, deklarata të përbashkëta dhe memorandume bashkëpunimi.

VI.II Takime të rëndësishme dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare.

VI.III Bashkëpunimi me Projektin EU IPA-2009.

VII. AKTIVITETE TË TJERA TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

VII.I Aktivitete për mbrojtjen e të dhënave personale.

VII.I Ekspoze e punës së kryer nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit gjatë vitit 2011.

VII.II Performanca Financiare.

VII.IV Trajtime të vazhdueshme me ITAP.

VIII. STRATEGJIA INSTITUCIONALE 2012-2013.

IX. TË DHËNA STATISTIKORE

Fjala Hyrëse e Komisionerit

Të nderuar zonja dhe zotërinj !

Në këtë vit të veprimtarisë së institucionit të Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale na është dashur shumë punë për të arritur rezultatet e dëshiruara. Është pozitiv fakti që shprehemi lirshëm për kontributin që kemi dhënë në realizimin e qëllimit dhe objektit të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

I është kushtuar një kujdes i veçantë sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit të individëve me rregullat që përcakton ligji për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu rëndësi e veçantë i është kushtuar përcaktimit të përgjegjësisë dhe detyrimeve që kanë kontrolluesit, në evidentimin e rasteve si dhe trajtimit të ankesave dhe inspektimeve të vazhdueshme. Mbi baza ligjore janë miratuar udhëzime dhe manuale të cilat kanë shërbyer në realizimin e një inspektimi administrativ të drejtë dhe objektiv.

Gjatë këtij viti kemi bashkëpunuar ngushtë me institucione publike, më qëllim përshtatjen e akteve të tyre ligjore me ligjin për mbrojtje e të dhënave apo dhe për hartimin e akteve të Komisionerit në mënyrë që të arrihen standarde të kërkuara nga ligji.

Stafi i KMDP-së ka bërë kujdes në përcjelljen e parimeve, që bëjnë shembull të mirë për ruajtjen e privatësisë për të gjithë shoqërinë.

Progresi i bërë është edhe rezultat i bashkëpunimit intensiv me projektin EU IPA – 2009 nga i cili jemi asistuar përgjatë këtij viti dhe kemi mundur të tepërmi zhvillime në kuadrin ligjor por edhe trajnime për stafin si dhe kontrolluesit me përfshirje të gjerë e nga sektorë të ndryshëm parë si të rëndësishëm në këndvështrimin e fushës sonë.

Sigurisht veprimtaritë tona kanë pasur në objektiv edhe implementimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit që kemi lidhur më parë me vendet homologe por jo vetëm, përmes të cilave kemi vendosur të shkëmbejmë eksperiencë nga punët tona me qëllime të përbashkëta por edhe të avancojmë në drejtime të tjera që institucionet nënshkruese kanë konkretizuar p.sh mbi nevojën e të punuarit në grup për të arritur nivel në legjislacion dhe përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale apo edhe në zhvillimin e ndërgjegjësimit të vazhdueshëm për të qenë përkrah vendeve më të zhvilluara.

Tashmë, është e ditur që një punë e nisur kërkon ritme për të vazhduar, kërkon performancë, kërkon edhe më shumë bashkëpunim, kërkon shpejtësi në teknologjinë e avancuar dhe gjithshka tjetër që në fakt ne shprehemi të bindur se me dëshirën e mirë dhe këmbëngulëse do të arrijmë pasqyrimin në standarde të lartë të këtij autoriteti pa dyshim, të parë si një ndër më të rëndësishmit në vend në mbrojtje të një të drejte themelore, privatësisë, anës më të çmuar të individit.

Ju faleminderit,

KOMISIONERI

Flora ÇABEJ (POGAÇE)

I. MISIONI I KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE.

Institucioni i Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale ka një fizionomi të plotë dhe të qartë, jo vetëm për të shpalosur vizionin e tij, por edhe për të shprehur angazhimin dhe motivimin e tij për të kryer detyrat e ngarkuara me ligj.

Në këtë kontekst, Zyra e Komisionerit ka si mision të saj :

- Promovimin e praktikës më të mirë në mbrojtjen e të dhënave personale për institucionet private dhe publike.
- Sigurimin për arritjen e standarteve të larta të vendeve të zhvilluara evropiane në zbatimin e rregullave të përpunimit të të dhënave personale dhe njohjen e zbatimit të drejtave të subjekteve të të dhënave personale.
- Organizimin efikas të pritjes së ankesave të subjekteve të të dhënave, verifikimeve të tyre nëpërmjet hetimit administrativ dhe marrjes së vendimeve të bazuara në ligj për zgjidhjen e tyre.
- Nxitjen e besueshmërisë në zbatimin e kërkesave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale nëpërmjet ngritjes profesionale të punonjësve të zyrës së Komisionerit, për të arrirë nivel të lartë intelektual dhe profesional.
- Gjetjen e balancimit të përshtatshëm midis sanksioneve që parashikon ligji dhe masave që inkurajojnë bindjen e kualifikimin e kontrolluesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave për përpunimin e të dhënave personale, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private të subjekteve të të dhënave personale.

II. NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM PËR VITIN 2011.

Qëllimi i mbikëqyrjes përgjatë vitit 2011, është realizuar nga Zyra e Komisionerit, nëpërmjet Drejtorisë së Inspektimit, bazuar në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, aktet nënligjore të Komisionerit dhe duke u angazhuar maksimalisht për përmbushjen e Rezolutës të Kuvendit të Shqipërisë, të datës 7 Korrik 2011 “për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2010”. Në këtë këndvështrim plani për veprim i miratuar ka synuar minimizimin e shkeljeve, trajtimin e ankesave dhe sqarimin e subjekteve të të dhënave, nëpërmjet zbatimit të planit të kontrolleve të planifikuara sipas fushave, inspektimeve pa njoftim në raste të kufizuara më qëllim verifikimin, si dhe në rastet e disa ankesave dhe informacionit të dhënë nga Drejtoritë e brendshme të institucionit, pranë të cilëve kontrolluesit kanë detyrimin të nftojnë mbi punën e tyre lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.

Në shumicën e rasteve, duke marrë në konsideratë objektin e urdhërit për kontroll dhe inspektim administrativ, natyrën e shkeljes administrative, njohurisë dhe dijenisë të kontrolluesit, fushës specifike ku operon kontrolluesi, etj, Zyra e Komisionerit ka synuar të evidentojë problematikat në përpunimin e të dhënave për kontrolluesit dhe ju ka dhënë atyre Rekomandime. Në rastet ku kontrolluesi, megjithë pasjen dijeni dhe asistencës së ofruar nga Zyra ka zgjedhur të mos zbatojë detyrimet me të cilat e ngarkon ligji, Zyra ka marrë masa administrative dhe ka vendosur gjoba përkatësisht.

Autoriteti gjatë kësaj periudhe synoi kualifikimin e punonjësve për t’ju përgjigjur sfidave në kushtet e përpunimit elektronik të të dhënave të të gjithë shtetësive dhe për këtë ka zhvilluar por edhe marrë pjesë në të gjithë organizimet me fokus arritje profesionale.

Po ashtu, është synuar dhe arritur rritja e efijensës nëpërmjet ndërtimit të një platforme të infrastrukturës së teknologjisë së përpunimit të informacionit dhe zhvillimit të performancës së burimeve njerëzore. Për këtë është realizuar menaxhimi elektronik i protokollit të institucionit dhe ai i burimeve njerëzore.

Gjithashtu, është arritur ngritja e sistemit bashkëkohor të komunikimeve elektronike në institucion. Ky sistem tanimë plotëson të gjitha kushtet tekniko fizike për komunikime të sigurt, konfidencialitet dhe integritet në ruajtjen e informacionit të përpunuar në këtë institucion.

Përafrimi dhe përshtatja e legjislacionit shqiptar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale me standardet ndërkombëtare është parë si objektiv i rëndësishëm dhe për tu arritur jnaë përdorur forma e mënyra nga më të volitshmet.

Në misionin e punës sonë për këtë vit kalenderik, prioritet ishte edhe hartimi i amendamenteve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale për të formuar një kornizë më të plotë ligjore pas rreth tre vite pune të autoritetit dhe kjo u arrit.

Rritja në publik dhe ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale u përcoll përmes intervistave televizive, tryezave me gazetarët, rekomandimeve të dhëna këtyre të fundit në mbrojtje të privatësisë së individit duke e balancuar këtë me të drejtën e informimit.

Zhvillimi dhe thellimi i bashkëpunimit me homologët ndërkombëtarë në kuadrin e asistencës së komunitetit evropian për zyrën e komisionerit ishte ndër fokusët e punës sonë dhe u shoqërua me pritshmëri pozitive.

III.SENSIBILIZIMI DHE REGJISTRIMI I KONTROLLUESVE.

III.I AKTIVITETE SENSIBILIZUESE.

Në fokus të autoritetit vazhdon të jetë dhe sigurisht nuk do të ketë ndërprerje trajnimit i vazhdueshëm i kontrolluesve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorë të ndryshëm publikë e privatë. Kjo domosdoshmëri evidentohet pasi puna e gjithësecilit duhet të karakterizohet nga zbatimi i ligjit për të mbrojtur të dhënat e kujdo në mnënyrën më të mirë të mundshme dhe që pasoja ndaj cdo individit të jetë tërësisht e minimizuar, larg riskut, që privatësia të jetë e të ruhet si e drejtë themelore e tij, që shërbimi të jetë në kohë me profesionalizëm e në kushte konfidencialiteti kur është rasti. Nën këtë vullnet;

Në Prill 2011, autoriteti i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Projektin për “Forcimin e Zyrës së Komisionerit” IPA 2009, organizoi një seminar me përfaqësues të kontrolluesve publik dhe privat. Seminari kishte në vëmendjen e tij njohjen e kontrolluesve në lidhje me temën “Aspektet e shqyrtuara të Sigurisë së Informacionit. Çfarë mund të mësohet nga shembujt e përzgjedhur evropianë”, mbajtur nga eksperti polak Stefan Szyszko i cili është gjithashtu anëtar i Shoqatës Polake të Oficerëve për Mbrojtjen e të Dhënave dhe bashkëpunon me Komisionerin Polak që prej vitit 1999. Në këtë seminar, të ftuar ishin përfaqësues nga institucione publike si: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ILDKP-së, ISSH-së, QKR-së, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare si dhe kompani private kryesisht të fushës së Telekomunikacionit dhe Sigurimeve.

Pjesëmarrësit u njohën me Direktivën 95/46 për Mbrojtjen e të Dhënave, koncepte dhe masa të rëndësishme të sigurisë së të dhënave si dhe u prezantuan kryesisht me figurën e Zyrtarit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (ZMDP) dhe shqyrtimin e kësaj praktike në disa prej vendeve të BE-së si psh në Holandë, Gjermani, Sllovaki e Poloni. Seminari evidentoi interesin e pjesëmarrësve, të cilët u angazhuan në diskutime rreth marrëdhënieve të zyrtarëve të mbrojtjes së të dhënave personale me Kontrolluesin si dhe Zyrën e Komisionerit. Gjatë këtij seminari u shpërndanë gjithashtu edhe fletëpalosje të përgatitura prej Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në Qershor 2011, në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u zhvillua një seminar ndërgjegjësues me përfaqësues të Dhomës së Tregtisë Greko-Shqiptare. Në këtë seminar u trajtuan disa tema kryesore nga përfaqësues të autoritetit, e kryesisht: “Parimet kryesore të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale”, “Autoriteti mbikëqyrës i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, “Detyrimi Ligjor për të njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” si dhe tema mbi sigurinë e Teknologjisë së Informacionit “Siguria nuk është një produkt por një proces” referuar nga ekspertë të IT. Gjatë seminarit pati edhe diskutime me përfaqësuesit e ardhur, mbi çështje të mbrojtjes së të dhënave personale. Ky seminar u realizua në vazhden e kontakteve të marra me dhomat e tregtisë të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë.

Në datë 30 Qershor 2011, në ambientet e Hotel “Monark“ në Tiranë, u mbajt një seminar ndërgjegjësues mbi mbrojtjen e të dhënave personale në Sektorin e Kujdesit Shëndetësor. Të pranishëm ishin punonjës nga institucioni i Ministrisë së Shëndetësisë dhe i institucioneve të tjera

si : QSUT, ISKSH, ASHR, Urdhëri i Mjekut, Qendra Kombëtare e Barnave etj. Në këtë seminar, nga ana e punonjësve të Zyrës së Komisionerit u prezantuan temat : “Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, “Autoriteti Mbikëqyrës, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe shpjegimi i disa rasteve praktike nga fusha e mbrojtjes së të dhënave”, “Siguria nuk është një produkt, por një proces”, “Trajtimi i Udhëzimit për Rregullat Themelore në lidhje me Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Sistemin e Kujdesit Shëndetësor si dhe Rekomandimet e dhëna nga KMDP”. Gjithashtu një tjetër temë e titulluar “Mbrojtja e të dhënave personale dhe të dhënat për shëndetin në Bashkimin Europian”, u mbajt nga Eksperti çek Jiri Mastalka, ekspert i ardhur pranë Zyrës së Komisionerit në kuadër të Projektit IPA 2009 “ Mbi forcimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Duhet përmendur fakti që gjatë këtij seminari pati edhe diskutime me pjesëmarrësit mbi çështje të mbrojtjes së të dhënave personale në sektorin e Kujdesit Shëndetësor. Gjithashtu u bë e mundur edhe shpërndarja e materialeve sensibilizuese mbi fushën e mbrojtjes së të dhënave të përgatitura nga stafi i Zyrës së Komisionerit.

Në kuadër të zbatimit dhe zhvillimit të projektit IPA-2009, organizimi i seminarit me temë "Përpunimi dhe publikimi i të dhënave personale në sistemin gjyqësor" u trajtua si një event tepër i rëndësishëm për shkak të ndjeshmërisë së kësaj fushe në përpunimin e shumtë të të dhënave personale të subjekteve. Parë në këtë këndvështrim, ky organizim një ditë reflektoi pjesëmarrje të gjerë të sistemit gjyqësor, atij të KLD-së, organit të Prokurorisë, por edhe Administratës si Avokaturës së Shtetit, Shërbimit të Provës dhe Sistemit të Burgjeve. Në këtë event ndër të tjerë u referua edhe nga Z. José López Calvo, Zëvendës Komisioner, i Zyrës së Komisionerit Spanjoll për Mbrojtjen e të dhënave mbi Sektorin Gjyqësor dhe Mbrojtjen e të Dhënave, duke paraqitur Shembuj konkret të Parimit të Konfliktit si dhe nga Znj. Diana Alonso Blas, Oficer i mbrojtjes së të dhënave / Kreu i Shërbimit të Mbrojtjes së të Dhënave, EUROJUST. Pjesë e rëndësishme e kësaj sipërmarrjeje ishte edhe referimi i Draft Udhëzimit për "Përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor", nga eksperti kryesor ligjor dhe procedural, Projekti i BE-së "Forcimi i Zyrës së Komisionerit mbrojtjen e të dhënave në Shqipëri për harmonizimin me standardet e BE". Aktiviteti ngjalli interes, diskutime të shumta, shkëmbeu eksperiencë, sugjeroi bashkëpunim për të ardhmen dhe arriti në konkluzion se të gjithë së bashku duhet të bëjmë progres në mbrojtjen e privatësisë së individit. Gjithashtu, event i ofroi për pjesëmarrësit certifikatën, materiale të shumta sensibilizuese të përgatitura nga projekti si dhe nga KMDP.

Me rastin e 23 Shtatorit, Ditës Ndërkombëtare të Etikës në Media, në mjediset e “*Albanian University*” u organizua një workshop me qëllim sjelljen në vëmendje të problematikës etike në media e cila aktualisht shqetëson audiencën dhe publikun. Të ftuar në këtë workshop ishin përfaqësues nga OSBE-ja, pedagogë të Shkencave të Komunikimit si dhe përfaqësues nga Instituti Shqiptar i Medias dhe Unioni i Gazetarëve. Komisioneri vec pjesëmarrjes nëpërmjet përfaqësuesve përcolli edhe fjalën përshëndetëse për të pranishmit, përmes së cilës u kërkuar rritja e bashkëpunimit mes Zyrës së Komisionerit dhe medias për ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e opinionit të gjerë publik mbi fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Në diskutimin që vijoi, nga ana e përfaqësuesve të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale iu kërkuar medias që të jetë më e vëmendshme dhe e kujdesshme gjatë publikimit të kronikave të saj me qëllim zbatimin rigoroz të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke mbajtur parasysh pikërisht

balancimin midis të drejtës për informim dhe ruajtjes së privatësisë. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Etikës në Media, një aktivitet i ngjashëm, në të njëjtën ditë u zhvillua edhe në disa vende të tjera të botës.

Në Tetor 2011, në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u mbajt seminari me temë “Siguria e të Dhënave Personale si detyrë parësore e Kontrolluesit dhe Përpunuesit në Sektorin Policor”. Në këtë seminar ishin të pranishëm specialistë nga Drejtoria e Qendrës së Përpunimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave. Nga ana e punonjësve të Zyrës së Komisionerit u prezantuan temat më të rëndësishme lidhur me veprimtarinë e autoritetit e kryesisht me këtë sektor, lidhur me zbatueshmërinë e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në këndvështrimin e sektorit policor si dhe çështje të rëndësishme të praktikave më të mira të sigurisë së informacionit. Të pranishmit diskutuan gjerësisht me specialistët e teknologjisë së informacionit të Zyrës së Komisionerit, mbi raste konkrete të cënimit të sigurisë së të dhënave personale dhe masat e domosdoshme për minimizimin e këtyre rreziqeve. Gjithashtu u bë e mundur edhe shpërndarja e dosjeve me fletëpalosje dhe broshura sensibilizuese të përgatitura nga stafi i Zyrës së Komisionerit mbi fushën e mbrojtjes së të dhënave si dhe pajisja me certifikatat përkatëse.

Sërish në muajin Tetor 2011, pranë ambienteve të Komisionerit u zhvillua një seminar i organizuar në bashkëpunim me Projektin IPA 2009, i cili synonte krijimin e një tabloje të përpunimit të të dhënave në fushën e noterisë. Në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe Ministrinë e Drejtësisë, u ftuan noterë që ushtrojnë aktivitetin e tyre në rajone të ndryshme të Shqipërisë. Përfaqësuesi i Autoritetit të Komisionerit, nëpërmjet një prezantimi, si dhe nëpërmjet dhënies së përgjigjeve praktike për pjesëmarrësit, informoi dhe paraqiti një ekspozë të përgjithshme për ngritjen dhe funksionimin e institucionit të pavarur të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si i zbaton këto kompetenca që i jep ligji institucioni i Komisionerit në lidhje me mbikqyrjen, zhvillimit të legjislacionit, aktet administrative, procedurat e inspektimeve dhe kontrolleve administrative, si dhe vendosjen e gjobave si masë administrative kur gjenden shkelje të ligjit. Gjithashtu, u synua që të bëhej një ekspozë e përgjithshme se çfarë parashikon legjislacioni, të shpjegohej politika dhe strategjia e Zyrës së Komisionerit, si dhe eksperiencia e deritanishme shoqëruar me raste konkrete. Në këtë seminar, për të familjarizuar noterët, si dhe për t’u bërë sa më praktike të kuptuarin e procesit të përpunimit të të dhënave nga ky sektor, u ftua dhe paraqiti prezantimin një nga ekspertët e BE-së, në kuadrin e Projektit IPA 2009. Të pranishmëve në këtë seminar iu shpërnadanë gjithashtu edhe materiale të ndryshme sensibilizuese nga fusha e mbrojtjes së të dhënave personale.

Në Nëntor 2011, sërish në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u mbajt seminari me temë “Njohja me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Në këtë seminar ishin të pranishëm specialistë nga Drejtoria e Qendrës së Përpunimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Nga ana e punonjësve të Zyrës së Komisionerit u prezantuan tema lidhur me ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Dokumentet biometrike si dhe mbi Sigurinë si një proces dhe jo një produkt. Gjatë seminarit u krijua një ambient i përshtatshëm për të diskutuar mbi çështjen e mbrojtjes së të dhënave personale.

Sërish gjatë muajit Nëntor, falë bashkëpunimit me Institutin e Trajnimit të Administratës Publike (ITAP), nëpërmjet përfaqësuesve të autoritetit të komisionerit u mundësua trajnimi i punonjësve të

administratës i të gjitha niveleve. Prezantimet që u mbajtën në këtë trajnim i përkitnin: “ Njohjes me Ligjin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale”, “ Autoritetit Mbikqyrës të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “, “Detyrimet të Kontrolluesve për të njoftuar Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” si dhe “Sigurisë së të Dhënave Personale – Metodë praktike”.

Trajnimi i mësipërm me të njëjtin rend prezantimi, u përsërit edhe gjatë muajit Dhjetor duke mundësuar kështu trajnimin e një pjese tjetër të punonjësve të administratës publike mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

Institucioni ynë ka synuar së tepërmi që përveç trajnimeve, fushatave sensibilizuese, etj, të organizojë takime të vazhdueshme me njërin prej pushteteve të rëndësishme në vend e pikërisht me gazetarët, të bashkëbisedojë me ta në tryeza e studio për të sjellë në vëmendje të tyre që reflektimi i punës së tyre përmes informimit duhet të jetë i balancuar me ruajtjen e privatësisë së individit nga cënimi i saj si një rrezik me pasoja të pariparueshme. Për këtë në shumë raste të përditshmet janë rekomanduar për të bërë kujdes të veçantë në mos përhapjen e të dhënave personale kryesisht të të miturve në mos identifikimin e viktimave apo fshirjen e imazheve, në respektimin e akteve ligjore e nënligjore në këtë fushë, etj. Kjo fushë e rëndësishme do të jetë sërish në fokusin e punës sonë të përbashkët me projektin me zhvillime e risi të tjera.

Viti 2011 është karakterizuar nga fushata sensibilizuese edhe mbi kërkesat e vetë institucioneve publike apo edhe private dhe që si objektivi i matshëm e në fokusin tonë institucional do të ketë vëmendjen e duhur në të ardhmen, do të ketë angazhimin maksimal për të pasur pritshmëri në zbatim.

Përgatitja dhe botimi i materialeve ndërgjegjëse

- Fletëpalosja për “Marketingun Telefonik”. Kjo fletëpalosje ndërgjegjëse i drejtohet të gjithë kontrolluesve dhe operatorëve në rolin e përpunuesit të cilët vetëm ose në bashkëpunim të ndërsjellët kryejnë marketingun nëpërmjet telefonit.
- Fletëpalosje për të rinjtë, e cila synon të informojë këtë grup moshë mbi rregulla të qarta për mbrojtjen e të dhënave personale (të fëmijëve, të rinjve si dhe për personat të cilët për shkak të pozicionit të tyre të punës kanë lidhje të drejtpërdrejta me ta), si dhe;
- Fletëpalosja “Mbrojtja e të dhënave personale të fëmijëve dhe të të rinjve”. Kjo fletëpalosje synon informimin mbi rregulla të qarta për mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve dhe të të rinjve si dhe për personat të cilët për shkak të pozicionit të tyre të punës kanë lidhje të drejtpërdrejta me ta (duke përfshirë, mësuesit, edukatorët, mjekët, asistentët social etj).
- Është publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit, Manuali për mbrojtjen e të dhënave shëndetësore me titull “*Shëndeti Juaj, Privatësia Juaj, Zgjedhja Juaj*”.

III.II NJOFTIMI I SUBJEKTEVE KONTROLLUES.

Fillimisht duhet thënë se identifikimi i subjekteve kontrollues që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë në vetvete nuk është një përgjegjësi dhe detyrim ligjor i zyrës së Komisionerit dhe nuk përcakton nëse subjektet e identifikuara janë apo jo kontrollues dhe nëse si

të tillë ata duhet të plotësojnë detyrimin për të njoftuar e regjistruar në Regjistrin e Kontrolluesve, i cili është i hapur për publikun. **Identifikimi mbetet një masë extraligjore strategjike e ndërmarrë nga vetë Zyra.** Detyrimi ligjor i Komisionerit mbetet për të shqyrtuar njoftimin, kërkuar informacion plotësues, vlerësimin e ligjshmërisë së përpunimit, përcaktimin e rasteve nëse për një përpunim të njoftuar kërkohet marrja e autorizimit të Komisionerit për disa lloje përpunimi, si dhe administrimi i këtij informacioni të njoftuar në regjistrin e hapur për publikun (nenet 21-26)

Në fakt duhet të jenë vetë subjektet kontrolluese të cilët duhet të binden se kryejnë përpunim të të dhënave personale dhe se bazuar në ligj janë kontrollues dhe se duhet t'i drejtohen Komisionerit **për të regjistruar një përpunim ose disa përpunime me anën e njoftimit.** Jo gjithmonë një person juridik apo fizik që është i regjistruar pranë QKR-së është automatikisht kontrollues i të dhënave personale.

Për të ndërgjegjësuar kontrolluesit Komisioneri ka gjetur mbështetjen e institucioneve si QKR, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, tek të cilat kontrolluesit kanë lidhje të drejtëpërdrejta dhe mund të informohen edhe mbi detyrimet që duhet të zbatojnë pranë nesh. Po ashtu janë përdorur edhe burime alternative si “Guida e Çelësit Online”, apo institucioneve në listën e APP-së, etj.

Sigurisht që sensibilizimi me mjete masive publike, media e shkruar dhe ajo audiovizive, si dhe nëpërmjet seminareve e trajnimeve në të gjithë territorin, është aplikuar në çdo rast nga Zyra e Komisionerit për të informuar dhe ndërgjegjësuar kontrolluesit për të plotësuar detyrimin për të njoftuar.

Procesi i njoftimit dhe i regjistrimit është një proces i cili është i vazhdueshëm dhe nuk mund të përmbyshet vetëm brenda një viti, pavarësisht se disponojmë (pra janë të identifikuar) lista subjektesh private e publike që kapin shifra me qindramijëra.

Edhe praktikat më të mira evropiane, si dhe ato të vendeve të rajonit e të vendeve të Evropës Lindore janë tregues se ky proces kërkon kohë dhe se nuk mund të përfundohet brenda një viti.

Edhe në këtë fillim viti si prioritet i punës së Drejtorisë së Regjistrimit ishte sensibilizimi i subjekteve kontrolluese, njohja me ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe zbatimi i detyrimit të tyre ligjor për të njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit për gjendjen e përpunimit të të dhënave personale. Kjo strategji kërkonte informacionin e duhur për të evidentuar kontrolluesit që ushtrojnë aktivitetin e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Pas hartimit të projekt-marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe negociatave paraprake, ripunimit të tekstit të këtij projekt-akti, bazuar edhe në sugjerimet e palës tjetër e në vijim të negociatave dypalëshe, më datë 25.01.2011 kjo marrëveshje u nënshkrua nga titullarët e të dy institucioneve. Për zbatimin e saj filloi menjëherë puna e përbashkët, duke përcaktuar fillimisht personat e kontaktit.

Në vijim të strategjisë së saj parësore për identifikimin e subjekteve kontrolluese private nëpërmjet Listës së Personave Juridik dhe Fizik të Regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Zyrës së Komisionerit dhe QKR-së, si dhe listës së subjekteve publike, Drejtoria e Regjistrimit ka vijuar me dërgimin e shkresave zyrtare

sensibilizuese drejtuar subjekteve kontrolluese duke i kërkuar plotësimin e detyrimit për njoftim, bazuar në Nenet 21-26 të Ligjit.

Gjithashtu për sensibilizimin e sektorit të arsimit të lartë privat, drejtorja u bazua në informacionin që përmban lista e bërë publike në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Sensibilizimi i këtyre universiteteve ka sjellë reagime pozitive në rritjen e numrit të përgjithshëm të njoftimeve.

Gjithashtu, pjesë e strategjisë sensibilizuese ka qenë edhe sensibilizimi i subjekteve kontrolluese nëpërmjet postës elektronike (e-mail).

Prioritet dhe objektiv tjetër i arrirë i Drejtorisë së Regjistrimit përmendet edhe asistencë e vazhdueshme që i është ofruar kontrolluesve që njoftojnë, me qëllim plotësimin e saktë të formularit të njoftimit. Kjo asistencë ju është ofruar nëpërmjet komunikimeve telefonike, postës elektronike dhe duke i pritur përfaqësuesit e këtyre kontrolluesve pranë Zyrrave të Komisionerit nga specialistët e Drejtorisë së Regjistrimit. Vihet re një përqindje më e lartë saktësie në deklaratimet e bëra nga kontrolluesit të cilët e kanë kërkuar këtë asistencë.

Po për sensibilizimin e subjekteve kontrolluese u shfrytëzuan edhe kontaktet e postës elektronike të subjekteve të publikuara në “Çelësi-Tiranë”.

Gjithashtu, në kuadër të po kësaj strategjie për vitin 2011, Drejtorja e Regjistrimit intensifikoi komunikimin në terren me subjektet kontrolluese, si p.sh. Dhoma e Tregëtisë, organet e pushtetit lokal, të cilët mundësuan sensibilizimin e subjekteve kontrolluese që kanë kontakte të vazhdueshme me këto subjekte për shkak të aktivitetit të tyre me anë të postës elektronike duke ju dërguar atyre paketën sensibilizuese të dërguar nga Drejtorja e Regjistrimit. Në këtë kuadër përmendim takimet e realizuara:

- Me Dhomën e Tregëtisë dhe Industrisë Tiranë;
- Me Dhomën Amerikane të Tregëtisë;
- Me Dhomën Shqiptaro-Greke të Tregëtisë;
- Me Dhomën Shqiptaro-Italiane të Tregëtisë;
- Me Shoqatën Shqiptare të Investitorëve të Huaj;
- Me Drejtorinë e Taksave të Bashkisë Tiranë;
- Me Shoqatën Shqiptare të Bankave.

Si rezultat i këtyre takimeve Dhoma Amerikane e Tregëtisë u angazhua tërësisht dhe bëri të mundur organizimin e Konferencës me temë: “Mbrotjtja e të Dhënave Personale dhe Kodi i Punës”, që u zhvillua në muajin Prill në të cilën Komisionerit Ju kushtua një hapësirë e veçantë kohore për të prezantuar: “Institucioni i Komisionerit për Mbrotjtjen e të Dhënave Personale, Roli dhe aktiviteti i tij. Detyrimi ligjor që kanë mbajtësit e të dhënave personale për të njoftuar pranë Komisionerit”. Në këtë takim pjesëmarrës ishin kontrollues të ndryshëm të cilët kanë kontakte të vazhdueshme me Dhomën Amerikane të Tregëtisë të cilët shprehën nevojën për më shumë dijeni mbi ligjin dhe autoritetin, përgjegjësitë dhe detyrimet reciproke.

Gjithashtu, në mbledhjen e radhës së organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave me pjesëmarrës përfaqësues të Bankave të Shqipërisë u dërgua një përfaqësues nga Drejtorja e Regjistrimit pranë Komisionerit për Mbrotjtjen e të Dhënave Personale, me qëllim parashtrimin e disa kërkesave që

kjo Drejtori kishte në kuadër të sensibilizimit të bizneseve që shlyejn detyrimet e tyre pranë këtyre bankave. Në këtë mbledhje përfaqësuesve të bankave ju bë me dije se, bankat kanë detyrimin ligjor që për çdo ndryshim në deklaratimet e tyre të bëra në Formularët e Njoftimit, duhet të bëjnë një deklaram të dytë ndryshimi.

Po ashtu, më datë 08.03.2011 pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit u zhvillua seminari me temë: “Mbi detyrimin Tuaj për të njoftuar Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” me pjesëmarrës nga Dhoma Shqiptaro-Greke e Tregtisë me qëllim sensibilizimin e tyre dhe dhënien e asistencës për përmbushjen e detyrimit ligjor ndaj Komisionerit.

Përvec përdorimit efikas të zhvillimit të takimeve, tryezave, jemi angazhuar në identifikimin e adresave të e-mailit duke përdorur publikimin në “Guidën e biznesit online” për të evidentuar subjekte juridike të fushave të ndryshme të biznesit me qëllim dërgimin e shkresave sensibilizuese për njohjen e Zyrës së Komisionerit dhe për rrjedhojë të deklaratimit me anë të formularit të njoftimit pranë saj si detyrim ligjor për të gjithë institucionet publike dhe private.

Jemi angazhuar në korrespondencën me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për marrjen dhe administrimin e listës elektronike siç parashikohet nga dispozita 2.1 e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr. 1732, Prot datë 26.01.2011 midis KMDP dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Po në zbatim të kësaj Marrëveshje dhe më konkretisht në zbatim të pikës 2.4 të nenit 2 të saj, është kontaktuar me shkresë, e-mail si edhe me telefon me Drejtoritë Rajonale të rretheve ku fillimisht u kërkuan të vendoseshin persona kontakti. Më pas është vijuar me 2 kërkesa që rrjedhin nga marrëveshja e lartpërmendur dhe më konkretisht në zbatim të pikave 3, 4, 5, dhe 7 të paragrafit 2.1 të nenit 2 të Marrëveshjes si vijon:

1. *“Diskutimi për gjetjen e mënyrave me qëllim sensibilizimin e kontrolluesve në rang qarku, si psh nëpërmjet stendave me broshura informuese të KMDP për njohjen e subjekteve me detyrimin për të njoftuar, në ambientet e drejtorive rajonale*
2. *Në zbatim të pikës 2.4 të nenit 2 të kësaj marrëveshje, të na vihen në dispozicion listat në rang qarku me emrat e subjekteve tatimore si dhe adresat postare të tyre. Gjithashtu do preferohej që lista të shoqërohet edhe me adresat e postës elektronike.”*

Pas këtyre kërkesave dhe përgjigjeve pozitive nga ana e disave prej Drejtorive Rajonale në qytetet Dibër, Durrës, Fier, Vlorë dhe Korçë, u dërguan **800 fletëpalosje** dhe **500 Formular Njoftimi** me qëllim sensibilizimin e tyre.

III.III MENAXHIMI I NJOFTIMEVE DHE REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE KONTROLLUES.

Në vijim sërish të strategjisë parësore të Drejtorisë së Regjistrimit për identifikimin e subjekteve kontrolluese private nëpërmjet Listës së Personave Juridik dhe Fizik të Regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Zyrës së Komisionerit dhe QKR-së, kjo drejtori ka dërguar rreth **5586 shkresa zyrtare sensibilizuese**

drejtuar subjekteve kontrolluese private dhe publike duke i kërkuar plotësimin e detyrimit për njoftim, bazuar në Nenet 21-26 të Ligjit.

Numri i njoftimeve të përpunimeve nga kontrolluesit në territorin e Republikës së Shqipërisë për **vitin 2011** është **1038**, si dhe numri total i subjekteve të regjistruara në Regjistrin Qendror të Subjekteve Kontrolluese për **vitin 2011** është **871**.

Gjithashtu, në sajë të politikës dhe strategjisë së saj për të ndihmuar e asistuar subjektet kontrolluese që njoftojnë, është kryer komunikimi telefonik me rreth **1664 subjekte** që kanë telefonuar pranë zyrave tona, si dhe janë pritur për sqarim dhe asistencë pranë këtyre zyrave rreth **445 subjekte kontrollues**.

Njoftimi pranë Zyrës së Komisionerit është realizuar sipas “*Formularit të Njoftimit*”, miratuar me Urdhërin e Komisionerit Nr. 66, datë 01.10.2009, i ndryshuar me Urdhërin Nr. 44, datë 07.05.2010. Ky njoftim është realizuar në dy mënyra, nëpërmjet aplikimit duke plotësuar dhe dërguar formularin e njoftimit online ose duke e shkarkuar, plotësuar dhe dërguar dorazi apo me postë pranë Zyrës së Komisionerit.

Pas delegimit për shqyrtim të formularit, nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Regjistrimit çdo formular njoftimi është regjistruar në protokollin elektronik të brendshëm të zyrës së Regjistrimit, i cili është krijuar me qëllim organizimin sa më mirë të informacionit mbi dosjet e subjekteve kontrollues. Më pas formulari është shqyrtuar nga specialisti që i është ngarkuar, duke pasur parasysh kërkesat e nenit 22 të Ligjit.

Bazuar në Nenin 23 të Ligjit, kemi trajtuar nëpërmjet kërkesës për informacion plotësues çdo deklaram që ka rezultuar i paplotë, i paqartë, si dhe për të verifikuar më tej ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave nga kontrolluesit, si dhe në kuadrin e kontrollit paraprak në rastet e verifikimit të domosdoshmërisë ligjore për paraqitjen e kërkesave për autorizimin e Komisionerit për përpunimin e të dhënave sensitive dhe transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale. Numri i informacioneve të kërkuara pas deklarimeve për vitin 2011 është **1027** dhe numri i informacioneve të marra nga kontrollues të ndryshëm është **561**.

Procedurat më tej kanë vijuar me hedhjen në sistem të të gjitha njoftimeve të ardhura me anën e formularit të plotësuar manualisht dhe dërguar apo dorëzuar me postë pranë Zyrave të Komisionerit. Gjithashtu, në përfundim të këtij procesi, kemi vijuar me regjistrimin për njoftimet që rezultojnë dhe deklarojnë se respektojnë përpunimin e të dhënave personale konform kërkesave të neneve 5 dhe 6 të Ligjit, pra publikimin *online* në Regjistrin e Hapur për Publikun.

Tashmë Regjistri i Njoftimeve është ngritur me një numër të konsiderueshëm njoftimesh dhe regjistrimesh nga ku subjektet e të dhënave, individët dhe publiku i gjërë ka informacionin mbi gjendjen e përpunimit të të dhënave personale, informacion i cili do të kontribuojë në ezaurimin e të drejtave të tyre pranë kontrolluesve, si dhe për të realizuar ankimimin pranë KMDP-së.

KMDP ka qënë tërësisht e përkushtuar për të realizuar objektivin e përcaktuar në strategjinë e vitit 2011 duke menaxhuar maksimalisht informacionin e ardhur nëpërmjet formularëve të njoftimit, shqyrtimin ligjor të deklarimeve dhe evidentimin e rasteve për verifikim dhe rasteve që përbëjnë kundërvajtje administrative.

IV. ZHVILLIMET DHE PËRMIRËSIMET NË KUADRIN RREGULLATOR LIGJOR.

IV.1 UDHËZIME.

Është synuar dhe bashkëpunuar ngushtë me projektin IPA-2009 i cili ka asistuar autoritetin tonë për të arritur zhvillime në kuadrin ligjor në përputhje me eksperiencat e ofruara nga ekspertë të projektit dhe nga dokumentet e paraqitur është arritur në draftimin përfundimtar të disa udhëzimeve në sektorë të vecantë por edhe të akteve të tjera të brendshme për ecurinë me intensitet të punës sonë. Udhëzimet kanë pasur si objekt zbatimin e rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale në sektorë të ndryshëm si në atë privat por edhe shtetërorë, kryesisht në përpunimin e të dhënave personale të punonjësve të punësuar në sektorin privat, në përpunimin e të dhënave të subjekteve në sektorin gjyqësor, në sektorin e hotelarisë, në atë të komunikimit elektronik dhe tregëtimit të drejtëpërdrejtë, përdorimit të të dhënave nëpërmjet CCTV, të dhënave të përpunuara në hyrje dalje të ndërtesave, etj.

Përgatitja e këtyre akteve është karakterizuar edhe nga bashkëpunimi me institucionet e linjës që i përkasin kryesisht zbatimit të tyre me qëllim marrjen e mendimeve paraprake. Gjithashtu, thuajse në të gjithë rastet është marrë edhe mendimi i Ministrisë së Drejtësisë.

Në këtë drejtim, janë miratuar dhe botuar në fletore zyrtare:

- Udhëzimi nr. 10, datë 06.09.2011 “Për përpunimin e të dhënave personale në kuadër të shërbimeve hoteliere”;
- Udhëzimi nr. 11, datë 08.09.2011 “Mbi përpunimin e të dhënave në sektorin privat”. Në kuadër të këtij udhëzimi është përgatitur manuali me titull “Të dhënat personale dhe privatësia juaj në punë”. Manuali përmban një informacion të përgjithshëm në lidhje me detyrimet e punëdhënësve, monitorimin në punë, të drejtën e punëmarrësve për t’ju drejtuar Komisionerit në rast pakënaqësie në lidhje me mënyrën se si punëdhënësi përpunon të dhënat e tyre personale. Ky standart ndërgjegjësues është dërguar për botim.
- Udhëzimi nr.12 , datë 21.12.2011 “Për kontrollin e identitetit në hyrje të ndërtesave”;
- Udhëzimi nr.13, datë 22.12.2011 ““Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme””;
- Udhëzimi nr.14, datë 22.12.2011 “Për përpunimin, mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në sektorin e komunikimit elektronik të publikut”;
- Udhëzimi Nr.15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor” ;
- Udhëzimi nr.16, datë 26.12.2011 “Për mbrojtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtëpërdrejtë dhe masat e sigurisë”;
- Manuali “Për Vlerësimin e Kërkesave për Miratimin e Transferimit të të Dhënave në Shtete të Huaja”, i cili është miratuar nga Komisioneri, me Urdhërin nr. 75, datë 12.12.2011. Ai është përgatitur me mbështetjen e ekspertëve të Projektit EU-IPA 2009 “Përforcimi i Zyrës së

Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” në kuadër të asistencës për hartimin e akteve ligjore e nënligjore në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Manuali synon përcaktimin e procedurave që duhet të ndjekë DÇPLMJ (Drejtoria e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë) për trajtimin e kërkesave të paraqitura nga ana e kontrolluesve, me qëllim pajisjen me autorizim për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale në shtete të tjera;

- “Manuali i Procedurave të Njoftimit”, i cili është përgatitur në bashkëpunim me ekspertët e Projektit EU-IPA 2009.
- Është miratuar “Strategjia për trajnimet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, dokument i cili synon të përmirësojë efektivitetin dhe performancën e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe financiare.
- Është miratuar Fjalori Terminologjik për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Fjalori është publikuar në faqen zyrtare të KMDP-së në internet.
- Është përkthyer zyrtarisht e publikuar në faqen tonë zyrtare Direktiva 95/46 e KE.
- *Është miratuar, publikuar dhe botuar për shpërndarje Udhërrëfyese me tetë parime të mbrojtjes së të dhënave personale për ti shërbyer subjekteve si një guidë për të njohur të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.*
- Është propozuar një shtesë në Vendimin Nr.584, datë 28.08.2003 “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, nëpërmjet të cilit të mund të përfshihet edhe KMDP në listën e institucioneve që i duhen dërguar akte për mendim përpara miratimit të tyre në KM. Ky propozim ka ardhur si rezultat i takimit të organizuar në KM ne drejtorinë juridike dhe si rezultat i diskutimeve të zhvilluara në këtë të, në prezencë edhe të drejtuesit të projektit me qëllim gjetjen e mënyrave më efikase për të përmbushur përgjegjësinë tonë institucionale.
- Në përmbushje të veprimtarisë së punës sonë për të sjellë pranë kontrolluesit cdo të re në kohë, është miratuar përditësimi i listës së vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale në zbatim të VKM nr.934, datë 2.09.2009 lidhur me transferimet ndërkombëtare të të dhënave personale duke përfshirë në listim edhe shtetin e Israelit por duke u kushtëzuar transferimi vetëm kur ai kryhet në rrugë elektronike pasi edhe vendimarrja për përcaktimin e nivelit për këtë shtet nga BE është kushtëzuar në këtë mënyrë.
- Është ndjekur rregullisht detyrimi institucional për të dërguar raportet periodike mujore mbi veprimtarinë e KMDP-së, Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura pranë Kuvendit të Shqipërisë. Në kuadër edhe të bashkëpunimit të vazhdueshëm me këtë organ kemi evidentuar në mënyrë të herë pas herëshme nevojën e dërgimit të projektligjeve për mendim në momentin e marrjes dijeni të qënies së tyre për diskutim në komisionet parlamentare duke synuar kështu që të përmbushim një ndër objektivet tonë më të rëndësishëm përputhshmërinë e legjislacionit të brendshëm me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Edhe kjo si një gjetje ka pasur rezultatet e duhura hera herës në kohë.

IV.II DHËNIE MENDIMI.

Mbi projektvendime, projekte të kontrolluesve, etj.

- Është dhënë mendim për projektvendimin “Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar dhe projektprotokollin e saj të zbatimit”.
- Është dhënë mendim mbi projekt/marrëveshjen ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Qendrës së Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri (CRCA).
- Është dhënë mendim mbi draft pyetësorin e regjistrimit të popullsisë dhe banesave, akt i paraqitur nga INSTAT.
- Është dhënë mendim AKEP për Rregulloren për “Mbajtjen e të dhënave të krijuara ose të përpunuara në lidhje me ofrimin e shërbimeve dhe/ose rrjeteve të komunikimeve elektronike”.
- Është dhënë mendim për projektvendimin “Për një shtesë në Vendimin nr. 824, datë 06.12.2006 “Për miratimin e institucioneve të autorizuara për verifikimin në mënyrë elektronike të gjendjes gjyqësore si dhe të formularit të vetëdeklarimit”, të ndryshuar”, dërguar nga Ministria e Drejtësisë.
- Është dhënë mendim për projekt-VKM për propozimin e projektligjit për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
- Është dhënë mendim për Projekt-Vendimin “Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”, dërguar nga Ministria e Brendshme.
- Është dhënë mendim për Projekt-Vendimin “Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Federale Austriake për shkëmbimin e ndërsjellë të të dhënave në çështjet e kontrollit të migracionit dhe çështjet e azilit”, dërguar nga Ministria e Brendshme
- Është dhënë mendim mbi Rregulloren “Për marrëdhënien e Gjykatës me Publikun”, miratuar me Urdhërin Nr. 6777/5, datë 30.9.2010, të Ministrit të Drejtësisë.
- Është dhënë mendim mbi projektvendimin “Për krijimin, regjistrimin, funksionimin, administrimin, ndëreveprimin dhe sigurinë e sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbarimit gjyqësor”, dërguar nga Ministria e Drejtësisë.
- Janë dhënë komente mbi “Rregulloren e Brendshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Sigurinë e tyre”, në sektorin e policisë. Kjo rregullore është fruit i bashkëpunimit të Zyrës së Komisionerit me Policinë e Shtetit , akt i miratuar në 23 maj 2011.
- Është dhënë mendim për “Projekt/protokollin për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë mbi ripranimin e personave të cilët qëndrojnë pa autorizim”, dërguar nga Ministria e Brendshme.

- Është dhënë mendim për “Projekt/marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Sllovaqe mbi bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të substancave narkotike dhe prekursorëve të tyre si dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme”, dërguar nga Ministria e Brendshme.
- Është dhënë mendim për “Projekt/marrëveshjen teknike ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Bashkimit European për Shtetin Ligjor në Kosovë (EULEX), mbi bashkëpunimin Policor”.
- Është dhënë mendim lidhur me “Marrëveshjen për Funkcionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat/Viktimat e Mundshme të Trafikimit të Personave” dhe është dërguar në rrugë elektronike pasi kjo ishte edhe mënyra e ardhur dhe kërkuar mendimi përkatës.
- Është dhënë mendim mbi projektin “Libri i kujtimeve” për nxënësit e shkollave të mesme (Publike dhe Jo-publike në Tiranë) për sa i takon mbledhjes dhe ruajtjes së të dhënave personale nga organizata “Projekti Shkolla Ime” dhe që do të realizohej nga kjo e fundit.
- Është raportuar lidhur me rolin dhe funksionin e autoritetit tonë në konferencën “Institucionet e Pavarura dhe Roli i tyre në Mbikëqyrjen e Reformës së Sektorit të Sigurisë në Shqipëri”, e cila u organizua nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.
- Është dhënë dhënë opinion ligjor Komitetit Shtetëror për Minoritetet mbi kërkesën e tij mbi përputhshmërinë ose jo të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligjit për censusin e popullsisë dhe banesave.

Mbi Projektligje.

- Është dhënë mendim për projektligjin “*Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*” dhe është dërguar në rrugë zyrtare në MASH. Është marrë pjesë në tryezën e rumbullakët të zhvilluar nga organizata “Save the children” për të diskutuar rreth Projekt-ligjit për “Sistemin arsimor parauniversitar”. Në këtë takim u diskutuan çështje me interes në lidhje me Kreun IX të këtij projekt-ligji, si një kapitull që sjell risi në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Është dhënë mendim për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8669, datë 26.10.2000 “Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe banesave”, të ndryshuar.
- Është dhënë mendim për Projekt-ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9157, datë 04.12.2003 “Për Përgjimet Telekomunikimeve”, i cili më pas i është dërguar Ministrisë së Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit.
- Është dhënë mendim për Projektligjin “Për Transmetimet me Zë dhe/ose Figurë në Republikën e Shqipërisë”, dërguar nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik , Kuvendi i Shqipërisë.
- Është dhënë mendim për Projektligjin “Për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet liria e lëvizjes me vendim gjyqësor”, dërguar nga Ministria e Drejtësisë.

- Është dhënë mendim për Projektligjin “Për statusin e nëpunësit civil”, drejtuar Departamentit të Administratës Publike dhe është bashkëlidhur relacioni shoqërues. Opinioni ligjor u parapri nga pjesëmarrja në takimin konsultativ realizuar në datën 8 Nëntor 2011, në ambientet e Hotel “Tirana International”. Në këtë takim pjesëmarrësit nga KMDP shprehën mendimet përkatëse duke parashtruar ndryshime që institucioni i Komisionerit i vlerëson të rëndësishme për Projektligjin në fjalë.
- Është marrë pjesë në tryezën e rrumbullakët që u organizua nga MITIK me qëllim dhënien e mendimeve për amendimin e ligjit nr.9918, dt. 19 maj 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, projekt/akt për të cilin KMDP ka dhënë mendimin përkatës në kohë.
- Në kuadër të përafrimit me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe standardet evropiane të mbrojtjes së të dhënave, janë përgatitur amendimet në Ligjin nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Ligjin nr.8792 datë 10.5.2001 “Për Krijimin e Qendrës së Përpunimit të të Dhënave”. Për përgatitjen e mendimeve përkatëse ka dhënë asistencë edhe eksperti i projektit IPA-2009 (Z. Emilio Aced Felez). Këto amendime, shoqëruar dhe me relacionin përkatës, janë dërguar në rrugë zyrtare edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Njohja dhe studimi i Fletoreve Zyrtare.

KMDP ka paraparë si një mënyrë gjetje të rëndësishme studimin e fletoreve zyrtare për të evidentuar miratimin e akteve ligjore të reja, për të parë përputhshmërinë e parashikimeve ligjore me fushën e mbrojtjes së të dhënave nëpërmjet të cilave lehtësisht dallohet nëse akti është dërguar pranë autoritetit tonë për mendim ose jo. Kështu p.sh në to janë evidentuar njohja me miratimin e disa prej ligjeve për të cilët KMDP nuk kishte dhënë mendim, e konkretisht; Ligji “Për noterinë”, Ligji nr. 9662 datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i dryshuar apo Ligji nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, i ndryshuar. Këto evidencime bënë që në bashkëpunim me projektin tanimë janë përgatitur amendime në dy ligjet e fundit dhe njëkohësisht i është tërhequr vëmendja shkresërisht të gjithë institucioneve që kanë nismën ligjore për të sjellë çdo projekt akt ligjor e nënligjor për mendim përpara miratimit të tyre në përmbushje të detyrimit të parashikuar në nenin 31 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Dhënie mendimi në kuadër të Bashkëpunimit ndërkombëtar.

Edhe autoritetet ndërkombëtare në vlerësim të punës dhe pjesëmarrjes aktive në tryeza e diskutime në të cilat jemi akredituar kanë dërguar për mendim dokumente të ndryshëm për të cilët kemi treguar vëmendje dhe në këtë drejtim;

- Është dhënë mendim mbi materialin me titull: “Study on Recommendation No. R (89) 2 on the protection of personal data used for employment purposes and to suggest proposals for the revision of the above-mentioned Recommendation”, nga Giovanni Buttarelli, në të cilin ndër të tjera parashikoheshin të dhënat biometrike dhe teknikat RFID me Frekuenca, që përdoren nga punëdhënësit për të mbledhur të dhënat personale e të punësuarve, si dhe është dhënë mendim mbi modernizimin e konventës nr.108 për të cilën është diskutuar gjatë në mbledhjen e komitetit konsultativ të vitit që lamë pas.

- Janë dhënë opinione pranë KoE lidhur me studimin e bërë me qëllim modernizimin e Konventës nr.108 “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”.
- Është raportuar pranë Komitetit Konsultativ të Konventës për Mbrojtjen e Individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale (T-PD) mbi veprimtarinë e Komisionerit për periudhën korrik-nëntor 2011.

IV.III PROPOZIMET KRYESORE NË AMENDIMET E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE GJATË VITIT 2011.

Arritje institucionale emërtohet përgatitja e amendimeve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, akt ky i cili është hartuar me ndihmën e projektit, është diskutuar gjerësisht, ka marrë mendimet dhe të gjitha opinionet e institucioneve të linjës dhe që tanimë pritet të kalojë në Kuvend pas miratimit që të tij në KM.

Në drejtim të përgatitjes së projektligjit, projekti, përveçse ka rekomanduar transpozimin e plotë të direktivës 95/46/EC, ka sjellë edhe parashikime nga eksperiencia e gjatë e punës në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, sipas zgjidhjeve të ngjashme ligjore që janë dhënë në vendet e Bashkimit Europain, si Hungaria.

Projektligji i paraqitur, parashikon në tërësi:

- Saktësime dhe përmirësime në disa dispozita të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me direktivën 95/46/EC;
- Propozime për transpozimin e plotë të direktivës 95/46/EC;
- Përf forcimin e rolit vendimarrës të Komisionerit, si autoritet i pavarur;
- Disiplinimin e punës së kontrolluesit, si dhe të këtij së tij me përpunuesin;
- Sanksione administrative më të larta në rast të konstatimit të shkeljeve të ligjit.

Me mbështetjen e plotë të MITIK në cilësinë e propozuesit për miratimin e këtij dokumenti të rëndësishëm së shpejti drafti i ri do të jetë pjesë e zhvillimeve të kuadrit ligjor dhe që sigurisht kësaj here me shumë risi. Draftimi kaloi disa faza, duke nisur kështu me analizën krahasuese të Direktivës 95/46 dhe Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, duke evidentuar edhe praktikatat më të mira ndërkombëtare të ofruara nga projekti, duke evidentuar edhe nevojat e pikasura gjatë inspektimeve të kryera, etj, për të shkruar dokumentin final mbi ndryshimet në këtë ligj. Pas marrjes së mendimeve dhe reflektimit të tyre vijuan procedurat ligjore përkatëse. Duhet thënë se, Kontrolluesit me miratimin e tyre do të jenë më të disiplinuar në këtë kornizë ligjore, do të duhet të bëjnë kujdes të veçantë në përpunimin e të dhënave personale për shkak të forcimit të sanksioneve në rast të konstatimit të shkeljeve e ndërsa subjektet e të dhënave do të jenë më të qartësuar në mënyrën e kërimit të të drejtave të tyre, etj. Sigurisht gjithshka nuk mbaron këtu pasi aktet ndërkombëtare vazhdojnë e integrohen dhe ne dosmosdoshmërisht shkojmë pas tyre për të qenë në qasje të plotë.

IV.IV TRANSFERIMI NDERKOMBETAR.

Si një ndër prioritetet e autoritetit tonë ka qenë dhe mbetet edhe trajtimi i kujdesshëm i kërkesave për transferim ndërkombëtar, pasi lëvizja e të dhënave mund të jetë një ndër momentet më të rëndësishme për të mundësuar keqpërdorimin e tyre. Fakti i numrit të pakët të këtyre kërkesave tregon që institucionet publike apo kompanitë private sigurisht kur realizojnë këtë lëvizje ushtrojnë detyrën në përputhje me bazueshmërinë ligjore përkatëse apo kanë marrë pëlqimin e subjekteve siç edhe mund të jenë në përputhje të plotë me njërën prej parashikimeve ligjore të ligjit për mbrojtje e të dhënave personale. Në të kundërt idendifikimi për të parë nëse kryhen lëvizjet ligjërish apo jo mund të arrihet vetëm nëpërmjet inspektimeve apo gjatë bërjes së njoftimeve. Aktualisht, në këtë drejtim;

- Është trajtuar kërkesa për transferim ndërkombëtar i të dhënave personale e paraqitur nga kontrolluesi LM Ericsson International AB (Zyra në Shqipëri) me përfaqësues ligjor Tonnuci&Partners. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me Vendimin nr. 01, datë 13.10.2011, “Mbi lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale”, ka autorizuar kontrolluesin LM Ericsson International AB (Zyra në Shqipëri), të transferojë të dhënat personale në Manila (Filipine), duke parashikuar edhe disa kufizime.
- Është shqyrtuar kërkesa për informacion, e bërë nga Banka SOCIETE GENERALE ALBANIA Sha, dhe lidhur me të kontrolluesi është plotësuar me opinionin e duhur ligjor për ecurinë e procedurës duke adresuar zbatimin rigoroz të parashikimeve ligjore të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale me qëllim transferimin e tyre në rastet e parashikuara për vendet me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes, konfirmim i cili është bërë në bashkëpunim me projektin.
- Është shqyrtuar kërkesa e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (Shërbimi Kombëtar i Punësimit), për paisje me autorizim për dhënien e listave të të diplomuarve jashtë vendit në 24 muajt e fundit, nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe opinionin ligjor për këtë kontrollues ka synuar që ti evidentojë dhënësit të të dhënave përveç bazës ligjore edhe masat e sigurisë që do të përdorë gjatë marrjes dhe përpunimit të të dhënave.
- Raiffaisen Bank e konsultuar për kryerjen e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale, është pajisur me opinion ligjor për veprimet që duhet të ndërmerret gjatë kësaj veprimtarie.

IV.V MARRËDHËNIE INSTITUCIONALE ME INSTITUCIONE TË TJERA.

Ministria e Integritit Europian.

Në përmbushje të axhendës ndërkombëtare të vendit tonë, rekomandimeve të BE-së, detyrimet institucionale kanë synuar bashkëpunimin e ngushtë me MIE dhe në këtë drejtim;

- Është dhënë mendim “Për komentet mbi Planin Indikativ shumëvjeçar IPA me shumëpërfitues 2011-2013”.
- “Mbi hartimin e Kalendarit të përkthimit të akteve evropiane në gjuhën shqipe për vitin 2011”, është përgatitur lista e akteve komunitare që Zyra e Komisionerit i konsideron si prioritare për t’u përkthyer.

- Është Raportuar mbi realizimin e detyrimeve të Institucionit të Komisionerit për periudha të ndryshme të vitit të kërkuara, sipas Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2010-2014.
- Në pjesëmarrjet në takimet e Komitetit të Stabilizim-Asociimit, është raportuar lidhur me veprimtarinë e zhvilluar nga KMDP gjatë periudhave të vitit 2011. Raportimet kanë synuar zhvillimet e kuadrit ligjor, zhvillimet e aktiviteteve me qëllim ndërgjegjësimin e qytetarëve, inspektimet e zhvilluara, etj.
- Kemi synuar pjesëmarrjen në ëorshop-e të organizuara nga kjo ministri për anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës 02: *Liria e lëvizjes së punëtorëve* dhe të Grupit Ndërinstitucional të Punës 19: *Politikat Sociale dhe Punësimi*. Objekti I këtyre takimeve ka qenë nisja e procesit për rishikimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), i cili do të përfundonte në fund të këtij viti.
- Po kështu është marrë pjesë në ëorshop-in e organizuar për anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës 23: *“Gjyqësori dhe të drejtat themelore”*. Objekti i këtij takimi ka qenë nisja e procesit për rishikimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), i cili do të përfundonte në fund të këtij viti.
- Është informuar mbi aktivitetet e realizuara nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për periudhën 1 maj 2011 - 1 shtator 2011 mbi hartimin e kontributit të dytë të Republikës së Shqipërisë për Raportin e Progresit 2011 të Komisionit Evropian për Shqipërinë.

Policia e Shtetit

Si një ndër sektorët më të rëndësishëm në vend dhe që në punën e përditëshme përpunojnë gjerësisht të dhëna personale të individëve e kryesisht sensitive, kemi bashkëpunuar ngushtësisht për të arritur legjislacion të përputhur si dhe për të profesionalizuar stafin e këtij sektori nëpërmjet seminarëve të organizuar enkas nga projekti, e në këtë drejtim;

- Është përgatitur në bashkëpunim me DPPShtetit rregullorja e veçantë e mbrojtjes së të dhënave personale përfshirë në të edhe masat e sigurisë dhe aktualisht është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm. Miratimi i këtij akti vlen për tu përmendur edhe për një arsye mjaft të rëndësishme pasi i përkiste njërit prej detyrimeve të përcaktuara për tu realizuar gjatë vitit që shkoi në rekomandimet e KE dhe konkretisht rekomandimit nr.9.
- Është bërë përditësimi i Pyetësorit mbi vlerësimin e mbrojtjes së të dhënave në Shqipëri në kuadrin e zbatimit të “Konventës për Bashkëpunimin Policor në vendet e Europës Jug-Lindore”.
- Janë dhënë Rekomandime në lidhje me përhapjen e të dhënave personale në median e shkruar të subjekteve të të dhënave personale për rastet e ndalimit të tyre, evidentimit të identitetit, të qenurit më parë të dënuar si dhe veprën penale për të cilën janë dënuar, etj, duke marrë shkas dhe konsideruar pikërisht burimin e informacionit dhe balancuar këtë të fundit me të drejtën e privatësisë së individit.
- Është dhënë mendim mbi “Draft-Raportin mbi Vlerësimin e Fushës së Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Republikën e Shqipërisë” hartuar nga Ekipi i Ekspertëve Vlerësues (i ardhur në Shqipëri në dt 23-25 Mars 2011) i ngritur për të siguruar zbatimin e “Konventës për Bashkëpunim Policor në vendet e Evropës Jug-lindore”.
- Është zhvilluar takim me Ekspertë të Europolit në prezencë të stafit të DPPSHtetit me qëllim vlerësimin e mbrojtjes së të dhënave personale në sektorin policor dhe evidentimin e rolit të Zyrës së Komisionerit në këtë fushë.
- Është dhënë mendim mbi projekt raportin e përgatitur nga Grupi i Punës së Ekspertëve të huaj “Për ndërmarrjen e një Vlerësimi në vend në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në

Republikën e Shqipërisë” për vlerësimin e punës së bërë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë (kryesisht në punën e sektorit policor sa i përket aplikimit të plotë të parimeve të Rekomandimit R (87) 15, duke përfshirë këtu edhe KMDP si autoritet mbikqyrës).

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

Në kuadër të bashkëpunimit me projektin dhe në përmbushje të një detyrimi të përbashkët për të zbatuar ligjin “Për gjendjen civile” është bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile e në këtë drejtim;

- Janë përgatitur dy drafte të dokumentave të cilët respektivisht i përkasin hartimit të “Përmbledhësës” që përcakton llojin dhe sasinë e informacionit që mund t’u jepet institucioneve të ndryshme, ky akt i cili në vazhdimësi do të miratohet nga të dy titullarët dhe do të shërbejë për përdorimin e të dhënave personale brenda kuadrit ligjor nga të gjithë institucionet të cilat kërkojnë të marrin të dhëna në përmbushje të detyrës së tyre funksionale. Për më shumë efikasitet në këtë bashkëpunim është realizuar edhe një **workshop** mbi “Përpunimin e të Dhënave Personale në Regjistrin Civil”, organizim i cili synonte që të përcillte eksperiencat ndërkombëtare më të mira të prezantuara nga ekspertë të huaj të cilët referuan dhe shpjeguan mbi përpunimin, mbrojtjen dhe marrjen e masave të sigurisë në këtë sistem.

Ministria e Drejtësisë

Në kuadër të bashkëpunimit të nënshkruar me këtë institucion tepër të rëndësishëm dhe në kuadër të përpunimit të shumtë të të dhënave personale nga institucione të varësi të tij apo edhe sektorë të brendshëm kemi bërë hapa përpara për të qasur legjislacionin e brendshëm pikërisht në njërin prej institucioneve të varësisë, e konkretisht;

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

- Është hartuar dhe miratuar me Urdhërin nr. 496, datë 28.09.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Rregullorja e Brendshme “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Sigurinë e tyre në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në I.E.V. Penale”. Ky akt është hartuar nga komisioneri në bashkëpunim me përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe ka për objekt përcaktimin e rregullave e parimeve për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale dhe masave për mbrojtjen e të dhënave personale të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në funksion të ruajtjes së rendit dhe sigurisë dhe parandalimit të ngjarjeve që rrjedhin nga cenimi i të dhënave personale për të burgosurit.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Në vazhdë të punës sonë bashkëpunuese kemi gjetur pozitivitet edhe me këtë institucion i cili ka konsideruar përmbushjen e detyrimit të dërgimit të projektakteve për mendim përpara miratimit të tyre sikundër edhe bashkëpunojmë në grupe për zhvillimin e kuadrit ligjor. Në këtë drejtim;

- Është marrë pjesë në Grupin ndërministror të Punës me qëllim dhënien e mendimeve në hartimin e projektligjit “Për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar”, në draftimin e të cilët është përfshirë mendimi ynë lidhur me zbatimin rigoroz të njërës prej elementëve më të rëndësishëm gjatë përpunimit të të dhënave atë të konfidencialitetit.

Pjesëmarrja është evidentuar edhe në trajnimin e organizuar përsëri në kuadër të funksionimit të Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e projektligjit “Për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar”.

- Është marrë pjesë në takime të zhvilluara të cilat kanë konsistuar në diskutimin e gjerë mbi situatën e krijuar nga largimi i familjeve romë nga banesat e tyre pranë Stacionit të Trenit Tiranë.

Pjesëmarrje në grupet e punës me institucionet e tjera.

- Është konsideruar dhe caktuar përfaqësuesi i KMDP në grupin e punës së ngritur pranë MSH, me qëllim përgatitjen e Strategjisë për Zhvillimin e Shëndetësisë. Në bazë të urdhrat të Ministrit të Shëndetësisë KMDP është anëtare e grupit të punës për hartimin e strategjisë kombëtare të Shëndetësisë Elektronike. Në kuadër të punës së kryer në grup është përgatitur dhe dërguar materiali mbi sistemet ekzistuese dhe nevojat për sisteme apo zgjidhje të reja në fushën e ICT në institucionin që përfaqësojmë, duke iu përmbajtur detyrimit tonë institucional. Kjo është një detyrë në vazhdimësi dhe që do të pasohet me materiale të tjera në shërbim të përgatitjes së strategjisë.
- Është marrë pjesë në Tryezën e Rrumbullakët që u organizua nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në kuadër të projektit “Përmirësimi i zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i mbështetur financiarisht nga Civil Right Defenders (CRD).
- Është marrë pjesë në takimin me temë “Në kuadër të hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, realizuar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në kuadër të vazhdimit të bashkëpunimit mes dy institucioneve tona është mirëpritur edhe kërkesa e bërë nga KMD për të nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi me KMDP dhe është bashkëpunuar në drejtim edhe të shkëmbimit të eksperiencave të punës sonë.

IV.VI PËRKTHIME.

- Janë përkthyer në shërbim të punës sonë dhe pasurimit të bibliotekës së autoritetit materiale nga revista "Privacy Law& Business,Data Protection & Privacy Information WorldWide" dhe rekomandimi mbi profilizimin i përgatitur nga Këshilli i Europës”. Këto akte ndihmojnë në pasurimin e bibliotekës sonë si fushë e re dhe tëpër specifike, ndihmojnë në përgatitjen e akteve të ndryshme nga ana jon, etj. Konkretisht mund të përmendim përkthimin dhe studimin e “Kodit të praktikës së CCTV-ve”, të punuar nga Zyra e Komisionerit të Informacionit në Angli. Janë përkthyer materiale të rëndësishme të cilat pasurojnë bibliotekën e Institucionit si dhe ndihmojnë në përgatitjen e akteve nga KMDP , si :“Aksesi në të dhënat personale (ICO)”; ”Rregullorja e politikave të privatësisë të Museumit të Viktorias”; “Korrigjimi i të dhënave personale të pasakta (ICO)”; ICO/ Electoral Register; “Regulation 17.1.R8, Under Statute 17.1 17.1.R8 – Code of Conduct for Research”.

V. PROCESI I INSPEKTIMIT.

V.I TRAJTIMI I ANKESAVE.

Zyra e Komisionerit për vitin 2011 ka marrë në shqyrtim të gjitha ankesat e subjekteve të të dhënave personale, të paraqitura pranë saj. Ankesat janë drejtuar nëpërmjet telefonit, në rrugë elektronike, si dhe kërkesa ankimore me shkrim. Në mbi 65 raste ankesash i ka trajtuar ato duke

dhënë sqarime dhe orientuar subjektet e të dhënave personale nëpërmjet telefonit, pasi këto ankesa nuk përbënin bazë për fillim të procedimeve administrative.

Përsa i përket ankesave të tjera, të cilat kanë qenë në kompetencë të Zyrës së Komisionerit, ato janë shqyrtuar nga inspektorët dhe subjeteve ju është dhënë orientimi i duhur për të ezauruar të drejtat e tyre, kur në thelb të ankesave ka qenë:

- Saktësia dhe informimi mbi të dhënat që përpunohen nëpërmjet sistemit TIMS nga organet e specializuara të policisë së shtetit;
- Lidhur me publikimin e të dhënave personale ne faqen zyrtare të QKR-se për të cilat shprehin mendimin se disa të dhëna nuk duhet të jenë të aksesueshme për publikun e gjere;
- Lidhur me publikimin e të dhënave personale ne websietin e ikub.al pa marrë pëlqimin e subjektit;
- Lidhur me ç’regjistrimin e biznesit (personit fizik) nga QKR-ja;
- Lidhur me informacionin e dhënë nga ana e autoriteteve policore për në gjykatë;

Lidhur me realizimin e një telefonate me përmbajtje promociionale nga ana e një kontrolluesi që i realizon këto shërbime, në numrin e telefonit celular.

Rastet Konkrete:

Janë trajtuar e shqyrtuar kërkesat apo ankesat e shtetasve të ndryshëm në cilësinë e subjektit të të dhënave, tipologjitë e të cilave kryesisht konsistojnë:

- Në përditësimin e të dhënave personale nga ana e kontrolluesve (“Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit”, “Ish-kooperativa bujqësore Zall-Bastar Tiranë).
- Në publikimin e të dhënave personale nga ana e kontrolluesve (“Qendra Kombëtare e Regjistrimit”, “ikub.al”).
- Në përhapjen e të dhënave personale nga ana e kontrolluesve (“Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit”, “Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë”).
- Në komunikimet tregtare me karakter reklame përmes mesazheve “sms” dhe drejt numrave të telefonave celulare nga ana e kontrolluesve (“top-shop”, “Instituti i dobësimit Orchid”, “Eder studio”).

Komisionieri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka shqyrtuar këto ankesa dhe ka dalë me orientime dhe rekomandime konkrete të tilla si:

- Duke orientuar subjektin e të dhënave personale që në zbatim të nenit 13 të ligjit nr.9887 dt.10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” t’i drejtohet me kërkesë për korrigjimin e të dhënave, për të cilat pretendohet se nuk janë të sakta, të vërteta dhe të plota kontrolluesit.
- Ka rekomanduar subjektin e të dhënave personale që në zbatim të nenit 13 të ligjit nr.9887 dt.10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të kërkojë nga kontrolluesi bllokimin e publikimit të të dhënave personale.

- I ka kërkuar kontrolluesit të kryejë trajnimin e stafit dhe që përhapjen e të dhënave personale në persona të tretë ta realizojë në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9887 dt.10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Ka orientuar subjektin që në zbatim të nenit 13 të ligjit nr.9887 dt.10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” t’i drejtohet kontrolluesit për të dhënë shpjegimet e duhura lidhur me telefonatat me karakter promocional, si dhe ka kërkuar nga kontrolluesi:
 - ndalimin e dërgimit të mesazheve “sms” me të cilat realizohen reklama dhe promocione.
 - mos vënien në dispozicion të të tretëve numra të telefonave celularë të klientëve pa marrë pëlqimin paraprak të tyre për përhapjen e këtyre të dhënave për të tretë.

V.II KONTROLI DHE INSPEKTIMI ADMINISTRATIV.

Pas hartimit dhe miratimit të planit të përgjithshëm miratuar nga Komisioneri, Drejtoria e Hetim-Inspektimit, për vitin 2011, ka ushtruar kontrolle administrative në 43 kontrollues të ndryshëm, nga të cilat në 33 kontrollues me aktivitet privat dhe në 10 kontrollues me aktivitet publik.

Objekti i kontrollit në shumicën e rasteve ka qenë i përgjithshëm, por që ka synuar të ezaurojë të gjithë sferën e mbrojtjes së të dhënave, nga verifikimi i parimeve të përgjithshme (neni 5), ligjshmëria e përpunimit (neni 6), përpunimi i të dhënave sensitive (neni7), transferimi ndërkombëtar i të dhënave (nenet 8-9), ezaurimi i të drejtave të subjekteve (nenet 12-16), ezaurimi i detyrimeve nga kontrolluesit (nenet 18-28) përfshirë edhe detyrimin për njoftim dhe konfidencialitetin.

Fushat ku ky kontroll është fokusuar janë: një pjesë e sistemit bankar, shoqëritë e telekomunikacionit, agjencitë turistike, sistemi shëndetësor privat dhe publik, disa institucione shtetërore që ofrojnë shërbime publike por disa të tjera që kanë një përqendrim dhe një përpunim masiv të të dhënave personale për shkak të veçantisë së legjislacionit mbi bazën e të cilit operojnë, si dhe media e shkruar.

Grupet e kontrollit në shumicën e rasteve, bazuar në prova dhe fakte, kanë konkluduar se kanë qenë përpara rasteve të këtyre shkeljeve:

- Hartimi i Rregulloreve të brendshme mbi sigurinë e të dhënave personale që përpunohen, si dhe politikat mbi mbrojtjen e të dhënave dhe kofidencialitetin;
- Mosplotësimi i detyrimit për të njoftuar;
- Mos informimi i subjekteve të të dhënave;
- Mos marrja e pëlqimit nga kategori të caktuara subjektesh të dhënash për disa përpunime specifike;
- Përpunimi i të dhënave të tepërta në tejkalim të qëllimit dhe jo në proporcionalitet;
- Mos parashikimi dhe moszbatimi i kriterëve për sigurinë e të dhënave;
- Bërja publike e disa të dhënave specifike, në tejkalim të qëllimit për të informuar publikun dhe vetë subjektin e të dhënave, si dhe mos anonizimi i të dhënave që janë bërë publike;
- Transferimi dhe përhapja e të dhënave në kundërshtim me ligjin dhe aktet administrative të Komisionerit; etj.

Në disa raste Komisioneri ka inspektuar kontrolluesit pa i njoftuar paraprakisht, në vijim të informacionit të ardhur nga Drejtoria e Regjistrimit, pasi për disa lloje përpunimesh të njoftuara

duhet të bëhej verifikim i mëtejshëm, veçanërisht në rastet e përpunimit të të dhënave sensitive, përpunimit me anën e kamerave CCTV dhe në rastet e transferimeve ndërkombëtare.

Për të gjitha këto shkelje Komisioneri ka dalë me Rekomandime, me qëllim shuarjen e shkeljes, krijimin e hapësirës ligjore nga vetë kontrolluesi për të garantuar mbrojtjen e të dhënave që përpunon, përputhshmërinë e veprimeve të përpunimit me parimet e Ligjit dhe akteve të Komisionerit.

Përgjatë vitit 2011 Zyra e Komisionerit, nëpërmjet Drejtorisë së Inspektimit ka ushtruar kontrolle për të verifikuar zbatueshmërinë e Rekomandimeve të dhëna nga Komisioneri në vijim të kontrolleve të mëparshme ushtruar në disa kontrollues. Në këtë kuadër janë verifikuar 3 kontrollues dhe në përfundim 1 kontrollues i kishte plotësuar pikat e rekomandimit, 1 kontrollues i kishte plotësuar pjesërisht ato dhe ju dha një rekomandim i dytë dhe për të tretin u dha një Vendim për gjobë për njëren nga pikat dhe një rekomandim i dytë për pikat e tjera.

Rastet Konkrete:

1. Kontrolluesi “Savatours” sh.p.k –Tiranë.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim, ku kontrolluesit i është lënë si detyrë:

- ✓ Në zbatim të neneve 3, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të hartojë rregullore të brendshme ose të përfshijë në rregullore seksionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kufidencialitetin sipas parashikimeve të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Gjithashtu, të përfshihen rubrika në lidhje me dhënien e pëlqimit nga klientët për përpunimin e të dhënave të tyre personale nga kontrolluesi.
- ✓ Në zbatim të neneve 3, 8, 9 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” ky kontrollues të përmbushë detyrimin në lidhje me transferimet e të dhënave për klientët duke përmbushur detyrimet që parashikon ligji dhe specifikisht Udhëzimi Nr. 1, datë 19.02.2010” Për lejin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personal”.

2. Kontrolluesi “Euromax” sh.p.k-Tiranë.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim, sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të Nenit 21, 22 dhe 23 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi duhet të riformuloj Formularin e njoftimit duke plotësuar të gjitha mangësitë e konstatuara nga grupi i inspektimit dhe të bëra të ditura kontrolluesit nëpërmjet procesverbalit dhe pjesës arsyetuese të këtij rekomandimi.
- ✓ Në zbatim të nenit 3, paragrafi 12, nenin 6 pika 1, shkronja “a” dhe nenin 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, kontrolluesi “EUROMAX” sh.p.k Tiranë, i cili përpunon të dhëna personale të klientëve dhe realizon marketing të drejtpërdrejtë nëpërmjet mesazheve (sms) në telefonat celular të tyre, duhet të sigurojë deklaratën specifike për dhënien e pëlqimit nga ana e këtyre personave për:
 - a. përpunimin e të dhënave personale;
 - b. marrjen e mesazheve (sms), për realizimin e marketingut direkt.

Deklarata dhe dhënia e pëlqimit duhet të jetë e ndarë dhe e veçantë për të dyja kategoritë e mësipërme, ku subjektet e të dhënave personale (klientët) duhet paraprakisht të informohen, në mënyrë të shkruar se, për çfarë konkretisht është duke dhënë pëlqimin, gjithashtu Formula e dhënies së pëlqimit duhet të jetë e ndarë në dhënien e pëlqimit nëpërmjet nënshkrimit klientit, për përpunimin e të dhënave dhe për dërgimin e materialeve informuese, publicitare ose promocionale.

Të gjitha këto duhet të jenë të parashikuara në Kartën e anëtarësisë (Application form) e cila i jepet klientit nga kontrolluesi. Tek kjo e fundit, theksojmë sërish që të dhënat e tilla si “Statusi civil “ dhe “Arsimi” të përfshihen në formularin e dhënies së pëlqimit për marketingun e drejtpërdrejtë, dhe të mos përfshihen te pjesa e Kartës së klientit (aplication form). Kjo do i mundësojë subjektit të të dhënave (klientit) se në çfarë procesi të iniciuar nga Kontrolluesi “Euromax”, ai dëshiron të përfshihet; në atë të anëtarësimit, sipas kartës që i jepet klientit, apo në atë të marketingut të drejtpërdrejtë, apo në të dyja bashkë.

- ✓ Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale” të vendosen tabela paralajmëruese për vëzhgimin me kamera të të gjitha ambienteve të brendshme, të kontrolluesit, të cilat janë të pajisura me sistemin survejues.
- ✓ Në zbatim të nenit 27/2, germa”ç”, kontrolluesi duhet të përcaktojë në një dokument ligjor, ose në kontratën sipërmarrëse lidhur me shoqërinë e ruajtjes dhe të sigurisë fizike “Pelican Security “ sh.p.k të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me aksesin dhe personat e autorizuar në të dhënat personale që përpunohen nëpërmjet sistemit të video survejimit.

3. Kontrolluesi “ **Pelican Security**”-Tiranë.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi “ Pelican Security “ sh.p.k të hartojë rregullore të brendshme ose të përfshijë në rregulloren ekzistuese seksionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kofidencialitetin sipas parashikimeve të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- ✓ Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “ Pelican Security “ sh.p.k, në rastet kur punonjësit e shërbimit të kësaj shoqërie, kanë akses në të dhënat personale që mbledhen nëpërmjet sistemit të video survejimit, në ambientet ku sigurohet shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike, të përcaktojë në një dokument të shkruar ose në marrëveshjen e lidhur midis palëve të drejtat dhe detyrimet e palëve në përpunimin e këtyre të dhënave, në veçanti të shprehet në mënyrë të detajuar kush e ka të drejtën e aksesit, personin e autorizuar për administrimin e CCTV.

4. Kontrolluesi “ **Gjinnazi Ismail Qemali**”-Tiranë.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të Nenit 21, 22 dhe 23 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi duhet të plotësojë të gjitha rubrikat në Formularin e njoftimit duke eliminuar të gjitha mangësitë e konstatuara nga grupi i inspektimit.

- ✓ Në zbatim të neneve 3, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të hartojë rregullore të brendshme ose të përfshijë në rregullore seksionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kofidencialitetin sipas parashikimeve të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- ✓ Të përcaktojë në një dokument të shkruar ligjor (ose në rregullore) personat që do të kenë akses në sistemin CCTV, kohën e ruajtjes së të dhënave, si dhe mënyrën e shkatërrimit të këtyre të dhënave.
- ✓ Të zbatohen parashikimet e Udhëzimit Nr. 3, datë 05.03.2010, “Mbi Sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

5. Kontrolluesi “**Emporiki Bank Albania S.A**”-Tiranë.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të nenit 27, germa “c” të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi duhet të rrimatojë sa më shpejt të jetë e mundur Rregulloren e posaçme “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- ✓ Në zbatim të nenit 18, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi duhet të hartojë rubrikën mbi dhënien e pëlqimit të klientit mbi transferimin e të dhënave, në urdhër pagesat, si një prej dokumenteve ope racionale të kësaj banke.

6. Kontrolluesi “**ALUIZNI**”-Tiranë.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të Nenit 21, 22 dhe 23 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi duhet të riformuloj Formularin e njoftimit duke plotësuar të gjitha mangësitë e konstatuara nga grupi i inspektimit.
- ✓ Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi duhet të hartojë rregullore të brendshme ose të përfshijë në rregullore aktuale seksionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kofidencialitetin sipas parashikimeve të ligjit të sipërmendur.
- ✓ Kontrolluesi duhet të aplikojë praktikën e kodimit, shifrimit ose numrit të dosjeve, për emrat e poseduesve. Gjithashtu, kontrolluesi duhet të kufizohet vetëm në publikimin e poseduesve me praktikën e kodimit, pa bërë publikimin e karakteristikave të objekteve.

7. Kontrolluesi “**Gjimnazi Qemal Stafa**” -Tiranë.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të Nenit 21, 22 dhe 23 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi, duhet të riformuloj Formularin e njoftimit duke eliminuar të gjitha mangësitë e konstatuara nga grupi i kontrollit, sic janë përshkruar në pjesën arsyetuese të këtij relacioni, brenda një afati kohor në vlerësim të Komisionerit të KMDP. Neni 23 “Komisioneri shqyrton të gjitha njoftimet dhe kur njoftimi është i pamjaftueshëm, ai urdhëron kontrolluesin të plotësojë të dhënat, duke përcaktuar edhe afatin kohor”.
- ✓ Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi duhet të hartojë rregulloren të brendshme ose të përfshijë në rregulloren ekzistuese seksionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kofidencialitetin sipas parashikimeve të ligjit të sipërcituar.
- ✓ Në zbatim të nenit 27 pika 2/ a, b, ç kontrolluesi duhet të përcaktojë në një dokument të shkruar ligjor, personat që do të kenë akses në sistemin CCTV, të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe periudhën e mbajtjes së të dhënave të regjistrimit.
- ✓ Të zbatohen parashikimet e Udhëzimit Nr. 3, datë 05.03.2010, “Mbi sistemin e video survejimit, në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sidomos në periudhën e mbajtjes së të dhënave të regjistrimit sipas argumentimit të dhënë në pjesën arsyetuese të këtij relacioni;
- ✓ Gjithashtu, në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi duhet të vendosë edhe tabela informuese të mëtejshme (për vëzhgimin me kamera) brenda zonës së shkollës, konkretisht në të gjitha korridoret që mbikëqyren me CCTV.
- ✓ Në respektim të nenit 8 të Konventës Europiane të Mbrojtjes së të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut, (si më lart cituam), por pa anashkaluar përcaktimet e bëra në nenin 17 të Kushtetutës së Shqipërisë, : ...”kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar atë”, pa tejkaluar në këtë mënyrë, kufizimet e parashikuara në këtë Konventë, sugjerojmë: pakësimin e numrit të kamerave survejuese, në ambientet e Gjimnazit “Qemal Stafa”, dhe vendosjen e tyre, vetëm në një nga korridoret e kësaj shkolle, për ta parë nëse justifikohet qëllimi, i vendosjes së tyre, si dhe sigurimin e proporcionalitetit të privatësisë së individit me kufizimin që e dikton atë.

8. Kontrolluesi “Spitali Amerikan” Qendra dhe Spitali Amerikan Nr. 2-Tiranë.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të neneve 27 të ligjit nr. 9887 datë, 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi të hartojë rregulloren e brendshme të posaçme, për mbrojtjen e të dhënave personale që ky kontrollues përpunon; këmbëngulim për rregullore të posaçme nisur nga potenciali i subjekteve të të dhënave personale si dhe gama e gjërë e të dhënave personale që grumbullohen.
- ✓ Të parashikohet në rregullore një seksion i veçantë për përdorimin e sistemit CCTV, kohëzgjatja e mbajtjes së të dhënave që sigurohet nga ky system (neni 5 pika 1/d), sidomos në lidhje me kamerat e vendosura në sallat e operacioneve, ku duhet të ketë një rregullim të vecantë.

- ✓ Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale “ të pajisen me tabela paralajmëruese të gjitha ambientet të cilat survejohen me kamera.
- ✓ Në zbatim të neneve 21, 22, 23 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi të plotësojë detyrimin ligjor, lidhur me riformulimin e formularit të njoftimit pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas konstatimeve të mangësive të përshkruara në pjesën arësytuese të këtij relacioni, brenda një afati kohor në vlerësim të Komisionerit të KMDP. *Neni 23 “ Komisioneri shqyrton të gjitha njoftimet dhe kur njoftimi është i pamjaftueshëm, ai urdhëron kontrolluesin të plotësojë të dhënat, duke përcaktuar edhe afatin kohor ”.*
- ✓ Në zbatim të nenit 5 pika 1/ (d): *Mbrojtja e të dhënave personale bazohet: “ në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej”,* kontrolluesi të përcaktojë rregulla të vecanta në lidhje kohëzgjatjen e mbajtjes së të dhënave, sidomos përsa i përket dosjeve të personelit që ndërpret marrdhëniet e punës me kontrolluesin, formularët e aplikimit për personat që nuk kalojnë të gjitha fazat e seleksionimit, për punësim.
- ✓ Në zbatim të nenit 5, pika 1/”c”, *Mbrojtja e të dhënave personale bazohet: “ të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim”* kontrolluesi në Formularin e aplikimit për punësim, të parashikojë të dhënat opsionale, të heqë ato të klasifikuara të tepërta, sipas pjesës arësytuese të këtij relacioni.
 - Të hiqet nga Formulari i aplikimit Rubrika. ”Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen për intervistë. Aplikimi dhe të gjitha dokumentat shoqëruese mbeten në pronësi e Univers- Alb sh.a dhe nuk mund të kthehen”.
 - Në formularin e Aplikimit për punë të shtohet një rubrikë ku të informohet subjekti i të dhënave në përputhje me nenin 18 të ligjit, në lidhje me përpunimin e të dhënave dhe ti bëhen të ditura të drejtat e tij, sipas parashikimeve të neneve 12- 17 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”.
 - Gjithashtu të hiqet rubrika “Kombësi” dhe të zëvendësohet me “Shtetësi” në aplikacionin e të dhënave që mblidhen për pacientin.

9. Kontrolluesi “ Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut”-Tiranë.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të Nenit 21, 22 dhe 23 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi, duhet të riformuloj Formularin e njoftimit duke eliminuar të gjitha mangësitë e konstatuara nga grupi i kontrollit, sic janë përshkruar në pjesën arësytuese të këtij relacioni, brenda një afati kohor në vlerësim të Komisionerit të KMDP. *Neni 23 “ Komisioneri shqyrton të gjitha njoftimet dhe kur njoftimi është i pamjaftueshëm, ai urdhëron kontrolluesin të plotësojë të dhënat, duke përcaktuar edhe afatin kohor ”.*
- ✓ Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi duhet të hartojë rregullore të brendshme pavarësisht se në rregulloret

ekzistuese janë të përfshira seksione sporadike për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin.

- ✓ Rregullorja duhet t'ju bëhet e njohur subjekteve të të dhënave, e cila mund të jetë dhe në faqen e tyre të internetit, nëse e kanë ose do ta kenë në të ardhmen. Kjo për faktin se ky kontrollues, jo vetëm është një kontrollues potencial për nga përmasat e grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave, por dhe për faktin se, këto të dhëna janë kryesisht sensitive.
- ✓ Kontrolluesi, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Tiranë, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, si institucion epror dhe hartues i akteve të saj, të marrin masat në lidhje me krijimin e kushteve për mirëmbajtjen e dokumentacionit nëpër dosje, dhe sistemimi i dosjeve nëpër dosje sipas problematikës. Gjithashtu të përcaktohet saktësisht personi përgjegjës, për mirëmbajtjen e dokumentacionit, dhe sistemin e dosjeve, sipas problematikës.

10. Kontrolluesi “Universiteti Evropian i Tiranës”-Tiranë.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Rishikimin dhe riformulimin e rregullores aktuale, për të realizuar një rregullore në funksion vetëm të mbrojtjes së të dhënave personale, pasi ky kontrollues konsiderohet një kontrollues potencial për sa i përket përpunimit, të të dhënave personale të subjekteve (studentë, staf akademik dhe administrativ).
- ✓ Të korrigjojë rubrikën F.III.3.2. “Transferimi i të dhënave personale”, në “Përhapje” ose “Transmetim” të të dhënave personale, pasi nga ana e kontrolluesit, është emërtuar gabim.
- ✓ Në mbështetje të gërmës “dh” të Udhëzimit Nr.3, datë 05.03.2010 “*Mbi sistemin e video survejimit, në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme*”, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili shprehet:
“*Subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video regjistrimi është në veprim, duke vendosur njoftimin e shkruar në hapësirën e monitoruar me përjashtim të rastit kur një e drejtë e veçantë dhe detyrimet që rrjedhin nga një ligj i veçantë janë duke u ushtruar.*”, kontrolluesi duhet të verë në dijeni subjektet e të dhënave personale (studentë, pedagogë) kur sistemi i kamerave në auditoret, (CCTV) aktivizohen, aktivizimi i cili realizohet vetëm në perudhë provimesh të studentëve.
- ✓ Gjithashtu në mbështetje të pikës 4/a të Udhëzimit Nr.3, datë 05.03.2010 “*Mbi sistemin e video survejimit, në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme*”, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili shprehet:
“*4. Detyrimet e një kontrolluesi i cili operon me një sistem të kamerave regjistruese të video survejimit, janë:*
a) *Sistemi i kamerave regjistruese të video survejimit nuk duhet të teprojë ndërhyrjen në jetën private të individëve. Një sistem video regjistrimi në thelb mund të instalohet, nëse qëllimi nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër (një pronë, për shembull, mund të mbrohet nga vjedhjet me kyç)*”, kontrolluesi, nuk duhet të aktivizojë sistemin e kamerave për efekt kontrolli të mbarëvajtjes së procesit të provimeve, në kushtet kur kapaciteti i studentëve arrihet të kontrollohet nga stafi akademik që kontrolluesi disponon.

11. Kontrolluesi “Gazeta Sot”-Tiranë.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi duhet të hartojë rregullore të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kofidencialitetin sipas parashikimeve të ligjit të sipërcituar.
- ✓ Të zbatohen parashikimet e Udhëzimit Nr. 9, datë 15/09/2010 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sidomos dhe për faktin se mediat ende nuk kanë një Kod Etik të tyre.
- ✓ Në respektim të nenit 8 të Konventës Europiane të Mbrojtjes së të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut, (si më lart cituam), por pa anashkaluar përcaktimet e bëra në nenin 17 të Kushtetutës së Shqipërisë, : ...”kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar atë”, pa tejkaluar në këtë mënyrë, kufizimet e parashikuara në këtë Konventë, sugjerojmë:
 - a. Ruajtja e anonimatit të subjekteve të të dhënave, të cilët janë pjesë e lajmit, dhe sidomos kur është fjala për minorenët apo adoleshentët.
 - b. Publikimin vetëm të inicialeve të subjekteve të të dhënave, të cilët janë pjesë e lajmit.
 - c. Minimizimin e të dhënave që identifikojnë subjektin, sa më shumë të jetë e mundur.

12. Kontrolluesi “Salloni i Bukurisë, Beauty Line”- Tiranë.

Është realizuar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit **Salloni i Bukurisë “Beauty line. Ky kontroll është iniciuar me indicie nga Drejtoria e Rregjistrimit**. Nga verifikimet dhe konstatimet gjatë kontrollit nga inspektorët u konstatua se nuk kishte vend për dhënie rekomandimi, pasi nuk kishte përpunim të dhënash personale nga ky kontrollues.

13. Kontrolluesi “Union Bank “ –Tiranë.

Ky kontroll është realizuar nga grupi i inspektorëve me përbërje S. Sata, H.Haxhillari(ky i fundit ka qënë edhe përgjegjësi i grupit, në lidhje me relacionin);

14. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë, 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi të hartojë rregullore të brendshme ose të përfshijë në rregulloret ekzistuese seksionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kofidencialitetin.
- ✓ Në zbatim të neneve 21, 22, 23 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi të plotësojë detyrimin ligjor, lidhur me riformulimin e formularit të njoftimit pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas konstatimeve të mangësive të përshkruara në pjesën arësytuese të këtij relacioni, brenda një

afati kohor në vlerësim të Komisionerit të KMDP. Neni 23 “ Komisioneri shqyrton të gjitha njoftimet dhe kur njoftimi është i pamjaftueshëm, ai urdhëron kontrolluesin të plotësojë të dhënat, duke përcaktuar edhe afatin kohor ”.

- ✓ Në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, të përcaktohen rregulla të qarta dhe në një dokument të shkruar, personat përgjegjës që kanë akses në programin kompjuterik me anë të të cilit përdorej mënyra e koduar ku studentët, pedagogët apo persona të stafit administrativ informoheshin në lidhje me rezultatet në provime, programet e lëndës, të dhëna të regjistrave të ndryshëm me të dhëna personale etj, detyrat e punonjësit IT , të drejtat dhe detyrimet e tij dhe të personave të tjerë që do të kenë akses në procese të tilla, si grumbullimi, regjistrimi, ruajtja, renditja, përshtatja, ndreqja, shfrytëzimi, përdorimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi etj, tek të dhënat personale që përmban ky program.
- ✓ Gjithashtu, për të dhënat që përpunohen manualisht, të përcaktohen në mënyrë të shkruar të drejtat dhe detyrimet e personave përgjegjës të cilët kanë akses në dokumentat që mbajnë të dhëna personale, kjo në funksion të sigurisë së këtyre të fundit.

15. Kontrolluesi “ Coca-Cola” sh.p.k.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Të plotësohet formulari i njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke deklaruar përpunimin e të dhënave biometrike dhe qëllimin e mbledhjes së këtyre të dhënave, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- ✓ Të hartohet rregullore e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin ose në rregulloren ekzistuese të përfshihet rubrikë në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale ku të parashikohet edhe kohëzgjatja e mbajtjes së të dhënave personale sipas qëllimit për të cilin ato janë grumbulluar, duke zbatuar kërkesat e neneve 5, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- ✓ Të vendosen tabela informuese në të gjitha ambjentet ku janë të vendosura kamerat e vëzhgimit, si dhe sistemi të administrohet nga persona të autorizuar që janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin, në zbatim të 18 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”.

16. Shtëpia Shkollore e Fëmijës, Shkodër.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Rishikimin dhe riformulimin e rregullores aktuale, për të realizuar një rregullore në funksion vetëm të mbrojtjes së të dhënave personale, kjo për faktin se, ky kontrollues, jo vetëm është një kontrollues potencial për nga përmasat e grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave, por dhe për faktin se, këto të dhëna janë kryesisht sensitive.

- ✓ Të deklarojë në seksionin, “Karakteristikat e sistemit të përpunimit”, rubrikën “përpunimi manual”, pasi është deklaruar, vetëm rubrika, “përpunimi automatik”.
- ✓ Kontrolluesi, Shtëpia e Fëmijës Shkollor, Shkodër, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, gjithashtu dhe me Bashkinë Shkodër, si institucione eprore dhe hartues të akteve të saj, të marrin masat në lidhje me krijimin e kushteve për mirëmbajtjen e dokumentacionit në dosje, dhe sistemimi i dosjeve sipas kërkesave të nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”-Gjithashtu të përcaktohet saktësisht personi përgjegjës, për mirëmbajtjen e dokumentacionit, dhe sistemimi i dosjeve, sipas problematikës.

17. Klinika Gjinekologjike “Glozheni”.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Bazuar në nenet 5,6 dhe 7 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të mos mblidhet e dhëna sensitive “ *prejardhja etnike*” për të dy kategoritë : pacient dhe bashkëshorti/partneri.
- ✓ Bazuar në nenin 30/1/b të Ligjit të fshini këtë të dhënë sensitive nga sistemi elektronik i menaxhimit të të dhënave, si dhe të shkatërroi e të fshini këtë të dhënë të mbledhur deri më tani për të gjithë pacientët dhe bashkëshortët brenda një afati prej 30 ditësh;
- ✓ Bazuar në nenet 21-22 të ligjit, të realizoni njoftimin për përpunimin e të dhënave për kategorinë “bashkëshorti/pacienti, brenda një afati prej 5(pesë) ditësh;
- ✓ Në zbatim të nenit 27/2”c” ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të hartojë rregullore të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kofidencialitetin: *Kontrolluesi “udhëzon operatorët pa përjashtim për detyrimet që kanë në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave,përfshirë dhe rregullat për sigurinë e të dhënave”.*

18. Klinika Gjinekologjike “ Ursula”.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të neneve 5 dhe 27 të ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, hartimin e një rregulloreje të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kofidencialitetin sipas parashikimeve të ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

19. Laborator Mjekësor “ Neo-Style”.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të neneve 5 dhe 27 të ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, hartimin e një rregulloreje të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe

kofidencialitetin sipas parashikimeve të ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

20. Laborator Mjekësor “ Intermedica”.

Në zbatim të urdhërit të Komisionerit është realizuar kontrolli administrativ dhe në përfundim të kontrollit është dalë nga Komisioneri me Rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Bazuar në nenet 21-22 të ligjit, të realizoni njoftimin për përpunimin e të dhënave për kategorinë “bashkëshorti/pacienti, brenda një afati prej 5(pesë) ditësh;
- ✓ Në zbatim të neneve 5 dhe 27 të ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, hartimin e një rregulloreje të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kofidencialitetin sipas parashikimeve të ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

21. Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor, Nr.1.

Në zbatim të urdhërit të Komisionerit është realizuar kontrolli administrativ dhe në përfundim të kontrollit është dalë nga Komisioneri me Rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Bazuar në nenet 21-22 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të realizoni pranë Komisionerit njoftimin për përpunimin e të dhënave personale për të cilat jeni përgjegjës, brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh;
- ✓ Bazuar në nenet 27/2 ”c” dhe 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të hartoni Rregullore të Brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin, brenda një afati prej 20 (njëzet) ditësh;
- ✓ Bazuar në nenet 5, 6, 7, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në rast nxjerrje jashtë përdorimi të kompjuterave, të shkatëroni njësitë *hard-disk* të PC-ve, për të mos bërë të mundur rikuperimin e çdo informacioni që mund të gjendet në to, brenda një afati prej 20 (njëzet) ditësh;

22. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë.

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Njohjen me Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe trajnimin e stafit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, rreth mbrojtjes së të dhënave personale. Zyra e Komisionerit ofron asistencën e saj për trajnimin e stafit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë;
- ✓ Nëse do të përhapni të dhëna personale tek të tretët, duhet të respektohen nenet 2, 5 dhe 6 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

23. Av. L.M, person fizik .

Nga verifikimet dhe konstatimet e grupit të inspektorëve dhe provave të depozituara në dosje, nga Komisioneri në përfundim është dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Formulimin e kërkesave më të plota drejtuar institucioneve publike, duke saktësuar qëllimin për të cilat mblidhen, grumbullohen dhe përpunohen të dhënat, për subjektet që përfaqësoni ligjërisht;
- ✓ Të gjitha të dhënat që mblidhen, grumbullohen dhe përpunohen për qëllim të aktivitetit të avokatit nuk duhen përdorur për qëllime të tjera, ndryshe nga ato për të cilat ato janë mbledhur.

24. Kontrolluesi “Savatours”.

Inspektim me qëllim verifikimin e Rekomandimit të mëparshëm. Nga grupi është konstatuar se nga kontrolluesi janë përmbushur rekomandimet.

25. Kontrolluesi “Euromax”.

Inspektim me qëllim verifikimin e Rekomandimit të mëparshëm. Është vendosur gjobë për mosplotësimin e detyrimit për njoftim (neni 21) dhe ndërkohë është dërguar një rekomandim i dytë me afat për raportim mbi përmbushjen e detyrimeve:

- ✓ Kontrolluesi, Euromax sh.p.k në zbatim të nenit 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe neneve 81-85 të Kodit të Procedurave Administrative të raportoje pranë Komisionerit mbi masat që janë marrë në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore të lëna, nëpërmjet Rekomandimit Nr. 40/2 prot, datë 21.3.2011 të Komisionerit, duke paraqitur edhe provat përkatëse. Konkretisht, duhet të raportohet në lidhje me pikat 2, 3 dhe 4 të rekomandimit të sipërpërmendur.

26. Kontrolluesi “ Coca-Cola” sh.p.k

Inspektim me qëllim verifikimin e Rekomandimit të mëparshëm. U konstatua se ishin përmbushur pjesërisht rekomandimet, ndërkohë është kërkuar informacion nëpërmjet postës-elektronike mbi bazën ligjore në lidhje me afatet kohore të mbajtjes së dokumentacionit:

- ✓ Në rubrikën për mbrojtjen e të dhënave personale, pjesë e Rregullores së Brendshme të kontrolluesit Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k., të parashikohet kohëzgjatja e mbajtjes së të dhënave personale, sipas qëllimit për të cilin ato janë grumbulluar, duke zbatuar kërkesat e neneve 5, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9887 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

27. Kontrolluesi “Conad Shqipëria”sh.a

Në zbatim të urdhërit të Komisionerit është realizuar kontrolli administrativ dhe në përfundim të kontrollit është dalë nga Komisioneri me Rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Realizimin në një formë tjetër të “formularit të pranimit” për kartën e anëtarësisë “Conad”.
- ✓ Në “formularin e pranimit” të shkruhet emri “Conad Shqipëria” si kontrollues i të dhënave personale që mblidhen nëpërmjet këtij formulari.

- ✓ Mbledhja e të dhënave personale me qëllim pajisjen me kartë anëtarësie “Conad” dhe nënshkrimi për këtë qëllim të jetë në vazhdimësi dhe në njërin anë të formularit.
- ✓ Të mos mbledhë të dhënën personale që lidhet me “mbiemrin e bashkëshortit” me qëllim pajisjen me kartë anëtarësie “Conad” për aplikantin.
- ✓ Mbledhja e të dhënave personale me karakter të përgjithshëm për aplikuesin dhe familjarët e tij me qëllim dërgimin e materialeve informuese, publicitare dhe promociionale dhe nënshkrimi për këtë qëllim të jetë në vazhdimësi dhe në anën e pasme të formularit. Në formular të shprehet qartë që plotësimi i tij nga subjektet e të dhënave personale nuk është i detyrueshëm.
- ✓ Përfshirjen në kontratën e sipërmarrjes “Për shërbimin e ruajtjes së objektit Conad Shqipëria” sh.p.k., të të drejtave, përgjegjësi reciproke, nivelet e aksesit të palëve dhe personat e autorizuar lidhur me përdorimin e sistemit të videosurvejimit (CCTV)-ve me shoqërinë e sigurisë fizike “Pelikan”, në kontratën e lidhur të shprehet qartë se përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale e mban kontrolluesi (“Conad Shqipëria”) dhe jo përpunuesi.
Rekomandimet e mësipërme janë zbatuar nga ana e këtij kontrolluesi.

28. Kontrolluesi “Intersig” sh.a-Tiranë.

Në zbatim të urdhërit të Komisionerit është realizuar kontrolli administrativ dhe në përfundim të kontrollit është dalë nga Komisioneri me Rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (brenda një afati të përcaktuar nën vlerësimin e Komisionerit) kontrolluesi “INTERSIG” sh.a të përmbushë plotësisht detyrimin lidhur me njoftimin pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke deklaruar:
 - Mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale për kategorinë “aplikant” (kandidatët që aplikojnë për tu punësuar pranë kontrolluesit) dhe kategorinë “furnizues”.
 - Mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave sensitive për kategorinë “klientë” dhe kategorinë “punonjës”.
 - Përhapjen e të dhënave personale tek të tretët
 - Transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale drejt shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave dhe shteteve që nuk kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.
- ✓ Në zbatim të nenit 5 pika 1/d dhe nenit 27/4 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “INTERSIG” sh.a të heqë nga arshivat fizike dosjet me dokumente që mbartin të dhëna personale për kategorinë punonjës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me këtë kontrollues.
- ✓ Kontrolluesi “INTERSIG” sh.a të zbatojë udhëzimin nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e videosurvejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, lidhur me të dhënave personale që mbledhen dhe përpunohen nëpërmjet sistemit të videosurvejimit (CCTV) në zyrën e financës dhe në korridoret.
- ✓ Në zbatim të neneve 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “INTERSIG” sh.a të përfshijë në rregulloren e brendshme që është duke hartuar një seksion të veçantë për kofidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka urdhëruar verifikimin e zbatimit të Rekomandimeve të dhëna dhe i njëjti grup që realizoi kontrollin ka bërë verifikimin dhe është konstatuar se kontrolluesi “Intersig” sh.a ka zbatuar plotësisht rekomandimet e dhëna.

29. Kontrolluesi “Albtelekom” sh.a- Tiranë.

Në zbatim të urdhërit të Komisionerit është realizuar kontrolli administrativ dhe në përfundim të kontrollit është dalë nga Komisioneri me Rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të nenit pika 1/b, c të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” , kontrolluesi “Albtelekom” të heqë nga dosjet e klientëve dokumentet që mbartin të dhëna personale (certifikatë pronësie të banesës, kontrata shitblerje, qiraje, vërtetim banimi etj..) të pa parashikuara në formularët tip të miratuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) dhe në të ardhmen të depozitojë vetëm dokumente që mbartin të dhëna personale për klientët, të parashikuar në formularin tip.
- ✓ Në zbatim të neneve 5 pika 1/d dhe 27/4 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” sh.a. dhe nenit 101 të ligjit nr. 9918 dt. 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” , kontrolluesi “Albtelekom” të shkatërrojë të dhënat personale që mbarten në skedarët (tabulatet e komunikimeve telefonike) të pajtimtarëve (klientëve) të cilët kanë plotësuar afatin dy vjeçar të ruajtjes së këtyre të dhënave.
- ✓ Në zbatim të neneve 5 pika 1/d dhe 27/4 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” , kontrolluesi “Albtelekom” të shkatërrojë, nga arkiva i saj fizik, dosjet me dokumente që mbartin të dhëna personale të klientëve të cilët kanë zgjidhur prej vitesh kontratën më këtë kontrollues dhe nuk kanë probleme juridike apo financiare.
- ✓ Në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” , kontrolluesi “Albtelekom” të marrë masa për përfshirjen në kontratat dhe marrëveshjet e lidhur me përpunues të ndryshëm (Banka, Posta Shqiptare etj) rregulla të qarta mbi të drejtat dhe detyrat e përpunuesit për garantimin e përdorimit të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale të klientëve të tij.
- ✓ Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “Albtelekom” të deklarojë në formularin e njoftimit të depozituar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale për kategorinë “Furnizues”.
- ✓ Në zbatim të neneve 5/1,c , 27/1, të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” si dhe udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, kontrolluesi “Albtelekom” të ndalojë mbledhjen dhe përpunimin e dhënave personale të punonjësve nëpërmjet përdorimit të sistemit të video survejimit (CCTV) në ambiente e punës (zyra me më shumë se 5- së punonjës) dhe korridore si dhe të hartojë rregullore të shkruar për qëllimin, mënyrat e mbledhjes dhe përpunimit, të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të video survejimit (CCTV).
- ✓ Në zbatim të nenit 27/1 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “Albtelekom” të hartojë rregullore për mënyrën e arkivimit dhe

kohën e ruajtjes të dosjeve me dokumente që mbartin të dhëna personale të klientëve dhe punonjësve të tij si dhe të përcaktojë rregulla të qarta për ruajtjen e konfidencialitetit dhe besueshmërinë për punonjësit që mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka urdhëruar verifikimin e zbatimit të Rekomandimeve të dhëna dhe i njëjti grup që realizoi kontrollin ka bërë verifikimin dhe është konstatuar se kontrolluesi ka zbatuar pjesërisht Rekomandimet e dhëna dhe nga ana e Komisionerit është caktuar një afat tjetër për plotësimin e plotë të rekomandimeve të dhëna.

30. Kontrolluesi “Porti Detar” Vlorë.

Në zbatim të urdhërit të Komisionerit është realizuar kontrolli administrativ dhe në përfundim të kontrollit është dalë nga Komisioneri me Rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të neneve 27/2 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “Porti Detar” sh.a Vlorë të përfshijë në rregulloren e brendshme “Kodi etik” dhe “Përshkrimi i detyrave” rregulla lidhur me përpunimin, konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale si dhe të hartojë rregulla lidhur me procedurat që ndiqen për shkatërrimin, asgjësimin e dokumentacioneve që mbartin të dhëna personale.
- ✓ Në zbatim të neneve 27/2 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, kontrolluesi “Porti Detar” sh.a Vlorë të hartojë rregullore mbi qëllimin e përdorimit, skemën, aksesin dhe kohën e ruajtjes së të dhënave personale që përpunohen nëpërmjet sistemit të videosurvejimit (CCTV) që ai përdor, si dhe të vendosë tabela paralajmëruese për përdorimin e sistemit të CCTV.

31. Kontrolluesi “Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë”.

Në zbatim të urdhërit të Komisionerit është realizuar kontrolli administrativ dhe në përfundim të kontrollit është dalë nga Komisioneri me Rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të neneve 27, 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të hartojë një rregullore të shkruar lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale gjatë aktivitetit të tij.
- ✓ Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, të hartojë rregullore për qëllimin e përdorimit, skemën, aksesin dhe ruajtjen e të dhënave që përpunohen nëpërmjet përdorimit të sistemit të CCTV-ve.
- ✓ Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të vendosë tabelat paralajmëruese për informim të qartë të subjekteve të të dhënave personale për përdorimin e sistemit të video vëzhgimit (CCTV-ve), pranë ambienteve të monitoruara të kontrolluesit “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor” Tiranë.

32. Kontrolluesi “**Fibank**” (**First Investment Bank - Albania**)Tiranë.

Në zbatim të urdhërit të Komisionerit është realizuar kontrolli administrativ dhe në përfundim të kontrollit është dalë nga Komisioneri me Rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të nenit 6 pika 1/a të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të merret pëlqimi specifik i klientëve bazuar në ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” përkatësisht në:
 - kërkesën për hapje llogarie bankare dhe çelje depozite bankare;
 - kontratat për hapje llogari bankare dhe çelje depozite bankare.
- ✓ Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të përmbushet plotësisht detyrimi lidhur me njoftimin pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke deklaruar mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale për kategorinë “furnizues”, “punonjës”.

33. Kontrolluesi “**Banka e Bashkuar e Shqipërisë**”(UBA).

Në zbatim të urdhërit të Komisionerit është realizuar kontrolli administrativ dhe në përfundim të kontrollit është dalë nga Komisioneri me Rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të nenit 5 pika 1/c të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të mos mbledhë të dhëna personale për “kombësinë” dhe “gjendjen gjyqësore” për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale “klient”.
- ✓ Në zbatim të nenit 21 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të plotësojë “Formularin e Njoftimit” duke deklaruar mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale “aksionerë”.
- ✓ Në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” nenin 5 pika 1 germa “c”, udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare” (neni 10 pika “a”), të ndalojë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, nëpërmjet përdorimit të kamerave CCTV, tej fasadës të godinave ku ushtron veprimtarinë bankare dhe financiare.

34. Kontrolluesi **Banka “ Credins”**.

Në zbatim të urdhërit të Komisionerit është realizuar kontrolli administrativ dhe në përfundim të kontrollit është dalë nga Komisioneri me Rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të nenit 5 pika 1/c të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” ndalimin e mbledhjes dhe përpunimit të dhënave personale sensitive lidhur me gjendjen gjyqësore, për anëtarët e familjes të punonjësve.
- ✓ Shkatërrimin nga arkivat fizike dhe elektronike, të të dhënave personale sensitive lidhur me gjendjen gjyqësore të mbledhura për anëtarët e familjes të punonjësve.

- ✓ Në zbatim të nenit 21 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të deklarohet në formularin e njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale për kategorinë “punonjës”.
- ✓ Në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” nenin 5 pika 1 germa “c”, udhëzimin nr. 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, rregulloren “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare” (neni 10 pika “a”), kontrolluesi Banka “Credins” Tiranë/
- ✓ Ndalimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të kamerave CCTV, tej fasadës të godinave ku ushtron veprimtarinë bankare dhe financiare.
- ✓ Shkatërrimin e të dhënave personale të mbledhura dhe përpunuara nëpërmjet përdorimit të kamerave CCTV, tej fasadës të godinave ku ushtroni veprimtarinë bankare dhe financiare.

35. Kontrolluesi “**Pro Credit Bank**”.

Në zbatim të urdhërit të Komisionerit është realizuar kontrolli administrativ dhe në përfundim të kontrollit është dalë nga Komisioneri me Rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” nenin 5 pika 1 germa “c”, Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme” të nenit 10 pika “a” të Rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare”, ndalimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të kamerave CCTV, tej fasadës të godinave ku ushtron veprimtarinë bankare dhe financiare brenda një afati 30 ditëve.
- ✓ Shkatërrimin e të dhënave personale të mbledhura dhe përpunuara nëpërmjet përdorimit të kamerave CCTV, tej fasadës të godinave ku ushtroni veprimtarinë bankare dhe financiare brenda një afati prej 5 ditëve.

36. Kontrolluesi “**Real Estate in Albania**”.

Kontroll administrativ është ushtruar kryesisht nga Komisioneri, nuk është bere njoftim paraprak për kontrolluesin. Nga kontrolli i ushtruar u konstatua se ky kontrollues është regjistruar në QKR dt. 12.02.2010 me nr. NIPT . L01409006D me objekt agjenci imobilare etj, por u konstatua që ky kontrollues nuk ka filluar aktivitetin e tij në fushën imobilare. Grupi i kontrollit administrativ ka mbajtur procesverbalin e konstatimit dhe dosja është arkivuar.

37. Kontrolluesi “**OMNIX Contracting & Engineering**”, Durrës.

Kontroll administrativ i ushtruar kryesisht nga Komisioneri, nuk është bere njoftim paraprak për kontrolluesin. Grupi i kontrollit administrativ gjatë kontrollit të ushtruar pranë këtij kontrolluesi konstatoi se: Kontrolluesi “Omnix Contracting and Engineering” sh.p.k. është regjistruar në QKR-së dt. 05.04.2010 me nr. NIPT. L01605502K, por nuk ka filluar akoma aktivitetin e tij. Ai ka bërë të gjitha procedurat pranë organeve shtetërore dhe funksionon vetëm me administratorin e

tij si person të punësuar. Grupi i kontrollit administrativ ka mbajtur procesverbalin e konstatimit dhe dosja është arkivuar.

38. Kontrolluesi “DNA & GREY” sh.p.k Tiranë.

Në zbatim të urdhërit të Komisionerit është realizuar kontrolli administrativ dhe në përfundim të kontrollit është dalë nga Komisioneri me Rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në protokollin e bashkëpunimit të shprehen detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve lidhur me konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale që mblidhen dhe përpunohen gjatë zbatimit të programit “zbulo botën time”.
- ✓ Konceptimin në një formë të re të formularit që ky kontrollues “DNA & GREY” sh.p.k përdor për mbledhjen e të dhënave personale, në të cilin pjesa informuese për subjektin e të dhënave personale, të vendoset përpara pjesës ku shprehet pëlqimi dhe nënshkrimi nga ana e subjektit të të dhënave personale.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka urdhëruar verifikimin e zbatimit të Rekomandimeve të dhëna dhe i njëjti grup që realizoi kontrollin ka bërë verifikimin dhe është konstatuar se kontrolluesi ka zbatuar plotësisht rekomandimet e dhëna.

39. Kontrolluesin “Wester Atlas Internacional”.

Në zbatim të urdhërit të Komisionerit është realizuar kontrolli administrativ dhe në përfundim të kontrollit është dalë nga Komisioneri me Rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “EESTERN ATLAS INTERNATIONAL, Inc. sh.p.k. duhet të përmbushë detyrimin lidhur me njoftimin pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke ju referuar aktivitetit të “Eestern Atlas International, Inc” Fier.

40. Kontrolluesi “Konsullata e Përgjithshme Shqiptare”, Selanik Greqi.

Në zbatim të urdhërit të Komisionerit është realizuar kontrolli administrativ dhe në përfundim të kontrollit është dalë nga Komisioneri me Rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Kontrolluesi “Konsullata e Përgjithshme Shqiptare” Selanik Greqi, nuk ka plotësuar njoftimin pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Komisioneri ka rekomanduar që në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi të përmbushë detyrimin për njoftim.

41. Kontrolluesi “Grand Hotel Europa” Shkodër.

Në zbatim të urdhërit të Komisionerit është realizuar kontrolli administrativ dhe në përfundim të kontrollit është dalë nga Komisioneri me Rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Komisioneri ka rekomanduar që në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi të përmbushë detyrimin për njoftim.

42. Kontrolluesi “Instituti i Dobësimit Orchid” Tiranë.

Në zbatim të urdhërit të Komisionerit është realizuar kontrolli administrativ dhe në përfundim të kontrollit është dalë nga Komisioneri me Rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të nenit 6 pika 1/a të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi “Instituti i Dobësimit Orchid” të mos kryejë dërgimin e mesazheve të tipit SMS të shkruara, drejt subjekteve të të dhënave personale (përdorues të numrave të telefonit), pa marrë pëlqimin paraprak të shprehur të këtyre subjekteve për ofrimin e një shërbimi të tillë.
- ✓ Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbështetur në nenin 30 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” duhet t’i kërkojë kontrolluesit “Eder studio” që në zbatim të nenit 6 pika 1/a të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të mos vejë në dispozicion të të tretëve numra të telefonave celularë të klientëve të pa marrë pëlqimin paraprak të tyre për përhapjen e këtyre të dhënave për të tretë.

43. Kontrolluesit “Çelësi” sh.p.k dhe “Çelësi Desing & Publicity” sh.p.k - Tiranë.

Në zbatim të urdhërit të Komisionerit është realizuar kontrolli administrativ dhe në përfundim të kontrollit është dalë nga Komisioneri me Rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” nenin 5 pika 1/c dhe udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme*”
 - Ndalimin e përdorimit të kamerave të vëzhgim-regjistrimit (CCTV) në dhomat e mbledhjeve që shërbejnë edhe për pritjen e klientëve të kontrolluesve.
 - Shkatërrimin e të dhënave personale (imazhet) të mbledhura dhe të përpunuara nga përdorimi i kamerave të vëzhgim-regjistrimit (CCTV) në zyrën e gazetës “Çelësi” dhe dhomat e mbledhjeve që shërbejnë edhe për pritjen e klientëve të kontrolluesve.

V.III MASAT ADMINISTRATIVE – GJOBAT.

Në zbatim të kompetencave të Komisionerit, pas mbylljes të procedurave të kontrollit dhe inspektimit administrative, janë vendosur 27 gjoba për kontrollues të ndryshëm pasi nuk kanë njoftuar përpunimet e të dhënave për të cilat janë përgjegjës.

Subjektet kontrollues të cilëve Komisioneri me Vendim ju ka dhënë masën administrative gjobë për mosplotësimin e detyrimit për njoftimin e përpunimeve pranë Zyrës së Komisionerit, bazuar në nenet 21 dhe 39/1/d janë:

- 1- Spitali Gjinekologjik “Nëna Geraldinë”;
- 2- Eagle Mobile
- 3- Ujësjellës Kanalizime Tiranë, sh.a;
- 4- Shkolla “Made SIPAM” sh.p.k;
- 5- Shkolla e Mesma Profesionale “Harry Fultz
- 6- ADC Klinik, Tiranë;
- 7- Klinika Private “Diplomat”, Tiranë;

- 8- KLINIKA E SYVE INTERNATIONAL
- 9- Klinika private Royal Diagnostic Center
- 10- Klinika HOLTER
- 11- Klinika private e specializuar Doro Lazer
- 12- Klinika private Egjan
- 13- Klinika private Amavita
- 14- Klinika private La Vita
- 15- Klinika private e specializuar “Laser Ëay”
- 16- Klinika private e specializuar “Klinika Kardiologjike 105”
- 17- Klinika Optike dhe Okuliste Gjergji Cepa
- 18- ARMO
- 19- EXPLORER TRAVEL & TOURS BENGASI
- 20- MAGIC TOURS
- 21- CONTINENTAL TRAVEL & TOURS Sh.p.k
- 22- Italia Travel & Tours Sh.p.k
- 23- Holiday Travel Agency Sh.p.k
- 24- ALBTOURS
- 25- DEA&SARA TOURS Sh.p.k
- 26- “Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor, Nr.1”
- 27- “Euromax” sh.p.k

Gjithashtu janë ndjekur seancat gjyqësore, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për lëshimin e urdhërave të ekzekutimit për vendimet e gjobave të vendosura nga Komisioneri për 13 kontrollues (1 kontrollues ka paguar vullnetarisht gjobën), për vitin 2010, që rezultonin në shkelje të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Gjithashtu, janë ndjekur të gjitha procedurat për dorëzimin e dokumentave në Zyrën e Përmbartimit- Tiranë. Në këtë kuadër, përveç ndjekjes së procedurave, janë realizuar si më poshtë:

- Tërheqja e vendimeve të lëshimit të urdhërit të ekzekutimit në gjykatë;
- Hartimi i kërkesave për ekzekutim të detyrueshëm në Zyrën e Përmbartimit;
- Dorëzimi i këtyre kërkesave në Zyrën e Përmbartimit;
- Hartimi i Autorizimeve përkatëse, etj.

VI. BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL DHE MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE PËR KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

VI.I MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI, DEKLARATA TË PËRBASHKËTA DHE MEMORANDUME BASHKËPUNIMI.

Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale një kujdes të veçantë i ka kushtuar bashkëpunimit me institucionet qendrore në vend, si domosdoshmëri kjo në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në ligj.

1. Në datën 24 Janar 2011, në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës u nënshkrua *Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*

dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje kishte si qëllim kontributin në rrugën e drejtë të mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë të nxënësve dhe të studentëve shqiptarë. Të dy palët shprehën angazhimin për vazhdimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të dy institucioneve, me krijimin e grupeve të punës të përbashkëta të formuar nga specialistë të fushës për të respektuar parimet e privatësisë të vendosura nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ministri i Arsimit z. Myqerem Tafaj u shpreh se Ministria e Arsimit dhe Shkencës i ka dhënë dhe do t'i jap gjithmonë një rëndësi të veçantë mbrojtjes së të dhënave personale, dhe do të bëjë kujdes të vecantë me qëllim marrjen e cdo opinionit ligjor autoritetit të Komisionerit për projektakte ligjore e nënligjore përpara miratimit të tyre.

Gjithashtu Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shprehu rëndësinë e veçantë që ka mbrojtja e të dhënave personale për nxënësit dhe studentët shqiptarë gjatë gjithë jetës së tyre shkollore, që prej shkollës fillore e deri në specializimet pasuniversitare, duke garantuar dhe mbrojtur të drejtën e tyre për privatësi. Përfshirja në këtë angazhim edhe i prindërve, do të jetë një prioritet i Zyrës së Komisionerit.



2. Në datën 19 Prill 2011, në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u nënshkrua ***Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.*** Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje forcon bashkëpunimin dypalësh ndërmjet dy autoriteteve të pavarura, duke e bërë atë më solid, më të drejtpërdrejtë dhe më institucional.

Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes mori pjesë dhe Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit Z. Genc Pollo, i cili në fjalën e tij theksoi mbështetjen e qeverisë në lidhje me krijimin dhe promovimin e kulturës së sigurisë në komunikimet elektronike dhe mundësimin e një komunikimi më të sigurt.

Pikërisht falë kësaj marrëveshjeje të iniciuar midis dy autoriteteve do të mundësohet bashkëpunimi më i ngushtë në rregullimin e kuadrit ligjor, inspektimeve të përbashkëta si dhe fushatës së ndërgjegjësimit për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale dhe komunikimit elektronik.



3. Në datën 19 Maj 2011, një delegacion i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, zhvilloi një vizitë pune pranë Agjencisë së Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Malin e Zi. Qëllimi i kësaj vizite ishte ***nënshkrimi i një deklaratë të përbashkët si dhe i një memorandum bashkëpunimi***, i cili do të nxisë bashkëpunimin e ndërsjellët të të dy vendeve në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale.

Me anën e kësaj Deklarate palët afirmuan bashkëpunimin e tyre aktual dhe gatishmërinë e tyre për ta vazhduar e intensifikuar bashkëpunimin e ndërsjellë. Ky bashkëpunim do të përmirësojë shkëmbimin e praktikave më të mira të eksperiencave dhe njohurive ndërmjet ekspertëve të të dy institucioneve. Përsa i përket Memorandumit, ai rregullon fushat, mënyrën e komunikimit dhe zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet palëve, në përputhje edhe me Deklaratën dypalëshe.

Palët informuan njëra tjetrën mbi zhvillimet më të fundit dhe masat e marra në vendet respektive. Në interes të përbashkët rezultuan çështjet në lidhje me masat më të fundit legjislative në kuadrin e përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së, veprimtarinë dhe rasteve konkrete të hetimeve administrative dhe kompetencave mbikëqyrëse, dhënien e rekomandimeve dhe ndjekjen e zbatueshmërisë së tyre nga subjektet kontrolluese, bashkëpunimi evropian e ndërkombëtar, etj.

Gjithashtu, ideja e hedhur në takimin e mëparshëm në Tiranë mbi organizimin dhe mbajtjen e një Konference Rajonale për forcimin dhe bashkëpunimin në rajon, është mirëpritur nga pala malazeze e cila më pas e konkretizoi bashkëpunimin pikërisht me organizimin e kësaj konference në Malin e Zi, me temat dhe çështjet më aktuale të mbrojtjes së privatësisë dhe të

dhënave personale, nga e cila mund të intensifikohen bashkëpunimet e mëtejshme në të ardhmen.



4. Në datën 09 Nëntor 2011, një delegacion i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, zhvilloi një vizitë pune në Prishtinë pranë Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Republikën e Kosovës. Qëllimi i kësaj vizite ishte ***nënshkrimi i një deklaratë të përbashkët si dhe i një memorandum bashkëpunimi***, i cili do të nxisë bashkëpunimin e ndërsjellët ndërmjet dy institucioneve dhe vendeve tona në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale.

Me anën e kësaj Deklarate palët afirmuan bashkëpunimin e tyre aktual dhe gadishmërinë e tyre për t'a vazhduar e intensifikuar bashkëpunimin e ndërsjelltë, duke marrë në konsideratë se agjencia kosovare është në hapat e para të krijimit të saj dhe eksperiencë e institucionit gjithashtu relativisht të ri por me eksperiencë 3-vjeçare do të kontribuonte në ecurinë e këtij institucioni të ri. Përsa i përket Memorandumit, ai rregullon fushat, mënyrën e komunikimit dhe zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet palëve, në përputhje edhe me Deklaratën dypalëshe.

Me qëllim të konkretizimit sa më të shpejtë të këtij bashkëpunimi, Komisionerja ftoi palën kosovare të marrë pjesë në Workshop-in me temë “Mbrojtja e të Dhënave Personale në sektorin e Policisë”, që u organizua në datën 13 Dhjetor 2011 në kuadër të Projektit IPA 2009 .



5. Është nënshkruar ***Deklarata e Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit Drejtues për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Maqedonisë dhe Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale***. Ky bashkëpunim u realizua për të rregulluar shkëmbimin e eksperiencave të praktikave më të mira dhe njohurive midis ekspertëve të të dy institucioneve lidhur me zhvillimin legjislativ, shkëmbimin e eksperiencës në fushën e zhvillimeve të reja teknologjike, transferimin e të dhënave personale, etj. Ishte mendimi i të dy autoriteteve se kjo Deklaratë Bashkëpunimi do të ndihmojë në efikasitetin e mbrojtjes së të dhënave personale të qytetarëve, të të dy shteteve.

6. Gjatë vitit 2011 u nënshkrua ***Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale***. Sipas kësaj Marrëveshjeje palët do të bashkëpunojnë në mënyrë të ndërsjellët për mbarëvajtjen e proceseve të hartimit dhe zbatimit të rregullave që garantojnë sigurinë e të dhënave personale që përpunohen nga strukturat tatimore, për plotësimin e detyrimit për njoftim pranë KMDP-së nga këto struktura, si dhe për bashkëpunimin në asistencën e ofruar nga DPT e DRT për bërjen me dije të subjekteve për detyrimin për njoftim pranë KMDP-së, në zbatim të ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

VI.II TAKIME TË RËNDËSISHME DHE PJESEMARRJE NË KONFERENCA NDËRKOMBËTARE.

1. Bazuar në Vendimin e Komitetit të Ministrave të vendeve anëtare në “Konventën për Bashkëpunimin Policor në vendet e Evropës Jug-lindore” dhe “Deklaratës së gatishmërisë” nga ana e Ministrit të Brendshëm, Grupi Ad-Hoc i Punës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më datën 23.03.2011 zhvilloi një takim në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Qëllimi i këtij takimi ishte vlerësimi në praktikë i aktivitetit të Zyrës së Komisionerit duke u bazuar në informacionin e pyetësorit të plotësuar dhe dorëzuar në vendet

anëtare dhe raportin e referuar në takimet e mëparshme. Në këtë takim, Znj. Flora ÇABEJ (POGAÇE) i njohu ekspertët me veprimtarinë e deritanishme të Zyrës së Komisionerit në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale si dhe iu përgjigj pyetjeve të ekspertëve në kuadër të pyetësorit, me qëllim krijimin e një ideje sa më të qartë në funksion të vlerësimit përfundimtar nga ana e tyre.

Grupi i ekspertëve përbëhej nga 14 ekspertë të policisë si dhe autoriteteve për mbrojtjen e të dhënave personale, të ardhur nga 8 shtete të rajonit si: Sllovenia, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Serbia, Rumania dhe Bullgaria. Në këtë takim ishin gjithashtu të pranishëm përfaqësues të Qendrës së Përpunimit të të Dhënave Personale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.



2. Më datën 15.02.2011, pranë ambjenteve të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u zhvillua një takim i kërkuar nga Z. Thomas Hammarberg, Komisioner i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut dhe Komisioneres Znj. Flora Çabej (Pogaçe) në kuadrin e një vizite të Z. Hammarberg në Tiranë, i cili zhvilloi gjithashtu një sërë takimesh me personalitete të larta të shtetit.

Biseda e Komisionerëve u përqendrua kryesisht në veprimtarinë e Zyrës në kuadrin e masave dhe strategjive të ndjekura në zbatim të ligjit, në kuadrin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë në Shqipëri. Znj. Çabej, fjalën e saj e përqendroi në angazhimet e ndërmarra dhe objektivat e realizuara përgjatë këtyre dy viteve të ngritjes së këtij institucioni të pavarur, duke i vënë theksin edhe asistencës së huaj e cila ka kontribuar dhe vazhdon të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve administrative të këtij institucioni.

Në kuadrin edhe të pyetjeve të parashtruara nga Z. Hammarberg, Komisionerja parashtri qendrimet e Zyrës në lidhje me zbatimin e kompetencave të saj në rastet kur nevojitet mbajtja e ekuilibrit ndërmjet të drejtës së informimit dhe të drejtës së privatësisë. Znj. Çabej siguroi Komisionerin Hammarberg se janë marrë masa të menjehershme ndaj shtypit të shkruar dhe

atij audio-vizual sa herë që nga ana e Zyrës janë evidentuar rastet që çenojnë privatësinë dhe të dhënat personale të shtetasve në artikuj dhe formate të tjerë informues.

Këto masa u shpjeguan edhe nëpërmjet rasteve konkrete kur Zyra e Komisionerit ju është drejtuar me rekomandime specifike përfaqësuesve të shtypit të shkruar dhe mediave audio-vizuale në lidhje me artikullin konkret të publikuar, si dhe për formatet e programeve televizive, duke ndërprerë përpunimin e të dhënave personale të individëve të përfshirë në situata të ndryshme, madje edhe për shkatërrimin e të dhënave të tepërta të mbledhura. Megjithatë, Znj. Çabej theksoi se informimi i publikut dhe liria e shtypit nuk është çënuar në asnjë rast dhe se mas-media në përgjithësi i ka respektuar dhe zbatuar udhëzimet dhe rekomandimet e saj.

Në tërësi, Komisioneri Hammarberg vërejti se institucionet respektojnë të drejtat e njeriut në këndvështrimin e privatësisë dhe bashkëpunimin e tyre me Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe shprehu mbështetjen e tij dhe të Këshillit të Evropës për Zyrën e Komisionerit.

Si përfundim të dy Komisionerët garantuan vazhdimësinë e bashkëpunimit në kuadrin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri, si vend anëtar i Këshillit të Evropës.



3. Në datën 10.03.2011, pranë ambjenteve të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbërriti një delegacion i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Malit të Zi i përbërë nga anëtarë të Këshillit të Agjencisë si dhe drejtues e inspektore të Zyrës së Komisionerit.

Znj. Flora Çabej (Pogaçe) Komisionere për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i uroi mirëseardhjen delegacionit të Malit të Zi të kryesuar nga Kryetari i Këshillit të Agjencisë Z. Shefkia Crnovrshanin. Biseda mes palëve u përqëndrua kryesisht në veprimtarinë e zyrave respektive në kuadrin e masave dhe strategjive të ndjekura në drejtim të zbatimit të ligjit, në aspektin e mbrojtjes së të dhënave personale si në Shqipëri ashtu edhe në Malin e Zi.

Znj. Çabej në fjalën e saj, nënvizoi angazhimet e ndërmarra dhe objektivat e realizuara përgjatë këtyre dy viteve të ngritjes së këtij institucioni të pavarur si; hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, ngritjen e sistemit të regjistrimit online, veprimtarinë e përgjithshme të hetimit inspektimit si dhe vazhdimësinë e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe sensibilizuese për mbarë

publikun e gjerë. Gjithashtu, Znj Çabej vuri theksin edhe në ndihmën e madhe të asistencës së BE-së në kuadër të projektit IPA 2009, e cila ka kontribuar dhe vazhdon të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve administrative të këtij institucioni.

Nga ana e pales malazeze, Z.Crnovrshanin, Kryetari i Këshillit të Agjencisë Malazeze si dhe Drejtori i Agjencisë, vlerësuan me nota shumë pozitive punën e kryer deri më tani nga ana e Zyrës Shqiptare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe diskutuan për tema të ndryshme në kuadër të shkëmbimit të eksperiencës mes dy palëve.

Gjatë takimit, si Znj.Çabej ashtu edhe Z.Crnovrshanin hodhën idenë e krijimit të një Forumi Rajonal, ku të përfshihen të gjithë Komisionerët e Mbrojtjes së të Dhënave Personale të rajonit. Krijimi i këtij forumi, do të ishte një mundësi shumë e mire bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale ndërmjet të gjithë vendeve të rajonit tonë.



4. E rëndësishme ka qenë edhe ***pjesëmarrja në muajin Prill në Konferencën Pranverore-Vjetore të Komisionerëve Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, në Bruksel***. Paraprakisht janë mbajtur korrespondenca të rregullta deri në finalizimin e këtij aktiviteti. Tema kryesore ishte rishikimi aktual i kornizës ligjore të mbrojtjes së të dhënave personale. Konferenca miratoi një Rezolutë në të cilën u theksua nevoja për një kornizë gjithëpërfshirëse të mbrojtjes së të dhënave personale e cila do të përfshijë sektorin e zbatimit të ligjit. Përfundimet e kësaj Konference konsiderohen tepër të rëndësishme nga Zyra e Komisionerit, pasi u diskutua për mundësinë e përfshirjes tonë si vëzhgues në veprimtarinë e Grupit të Punës Neni 29 i cili është i përbërë nga përfaqësues të autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave personale të Shteteve Anëtare të BE-së dhe i siguron Komisionit Evropian këshilla të pavarura për çështje të mbrojtjes së të dhënave personale e ndihmon në zhvillimin e politikave të harmonizuara për mbrojtjen e të dhënave personale në BE .



5. Takimi vjetor i 13-të i Asamblesë së Autoriteteve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Evropës Qendrore dhe Lindore u zhvillua më 28 dhe 29 Prill 2011 në Budapest. Mikpritës i takimit ishte Dr András Jóri, Komisioneri Parlamentar për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Lirinë e Informacionit të Hungarisë.

Në këtë takim morën pjesë delegacione nga 17 vende të Evropës Qendrore dhe Lindore. Delegacioni shqiptar përbëhej nga Znj. Flora Çabej, Komisionere për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe nga Këshilltari. Në këtë takim Komisioneri shqiptar mori pjesë si anëtar me të drejta të plota të kësaj Asambleje pranuar në Takimin e 12-të mbajtur në Maj të vitit 2010 si dhe bëri prezantimin e parashikuar në axhendën e takimit.

Gjatë takimit, pjesëmarrësit paraqitën nëpërmjet prezantimeve dhe diskutimeve çështje rreth legjislacionit kombëtar të mbrojtjes së të dhënave, pavaresinë e tyre, rolin dhe funksionimin e autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave personale që përfaqësonin, si dhe implementimin Direktivës 95/46/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë në përgjithësi.

Komisioneri zhvilloi takime me kryetarë dhe anëtarë të delegacioneve të disa shteteve pjesëmarrës në këtë takim. Z. Jacob Kohnstamm, Kryetar i Grupit të Punës për Nenin 29 dhe njëkohësisht Kryetar i Autoritetit Hollandez për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, diskutoi për sfidat e reja me të cilat Autoritetet e Mbrojtjes së të Dhënave Personale po ballafaqohen aktualisht.

Në këtë takim gjithashtu u miratua një rezolutë ku urohej mirëseardhja për dy anëtarët më të rinj siç ishin shtetet e Serbisë dhe Ukrainës, si dhe shprehja e dëshirës së mirë për bashkëpunim të mëtejshëm.

6. Në datën 15 Korrik 2011, pranë ambjenteve të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbërriti një delegacion i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Kosovës i përbërë nga Kryembikëqyrësi Z.Ruzhdi Jashari, dhe Zv.Mbikëqyrësi Z.Mentor Hoxhaj.

Znj. Flora Çabej (Pogaçe), Komisionere për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi i uroi mirëseardhjen delegacionit nga Republika e Kosovës, u bëri miqve një ekspozitë të përgjithshme të punës së deritanishme të kryer nga Zyra e Komisionerit. Znj.Çabej në fjalën e saj, nënvizoi angazhimet e ndërmarra dhe objektivat e realizuara përgjatë kësaj periudhe të ngritjes së këtij institucioni të pavarur si: hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, ngritjen e sistemit të regjistrimit online dhe fillimin e procedurave të shqyrtimit të njoftimeve dhe regjistrimit të tyre, veprimtarinë e përgjithshme të hetim inspektimit si dhe vazhdimësinë e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe sensibilizuese për mbarë publikun e gjerë. Gjithashtu, Znj Çabej vuri theksin edhe në ndihmën e madhe të asistencës së BE-së në kuadër të projektit IPA 2009, e cila ka kontribuar dhe vazhdon të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve administrative të këtij institucioni.

Nga ana e palës kosovare, Z.Jashari, Kryembikëqyrës i Agjencisë Shtetërore të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, vlerësoi me nota shumë pozitive punën e kryer deri më tani nga ana e Zyrës Shqiptare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe diskutuan për tema të ndryshme në kuadër të shkëmbimit të eksperiencës mes dy palëve. Si institucion i ri, Agjencia Kosovare shprehu interes për tu njohur e për të aplikuar praktikat më të mira të Zyrës Shqiptare të Komisionerit. Znj. Çabej u shpreh e gatshme për të mbështetur maksimalisht punën e institucionit kosovar, duke mbajtur kontakte të vazhdueshme dhe duke krijuar hapsira të reja bashkëpunimi.



7. Është kryer një vizitë studimore me qëllim njohjen me procedurat e investigimit dhe inspektimit, përafrimit të legjislacionit shqiptar me EU acquis në mbrojtjen e të dhënave personale pranë Byrosë së Inspektorit të Përgjithshëm për Mbrojtjen e të Dhënave në Poloni, Varshavë në datat 21-23 Shtator. Më datë 21 Shtator Komisioneri ishte pjesëmarrës në Konferencën Ndërkombëtare të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, organizuar sërish në Varshavë nga institucioni homolog i Polonisë (GIODO).

VI.III BASHKËPUNIMI ME PROJEKTIN EU IPA -2009

Është bashkëpunuar në vazhdimësi me ekspertët e projektit lidhur me plotësimin e kërkesave për dhënie informacioni apo materiale të përgatitura si p.sh ai mbi procesin legjislativ në Republikën e

Shqipërisë si dhe janë marrë masa nëpërmjet korrespondencave shkresore me institucione të tjera për të mundësuar takime specifike të kërkuara prej tyre (ekspertëve).

Në datat 13-18 Nëntor 2011, është zhvilluar një vizitë studimore trajnuese pranë Autoritetit Spanjoll të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Autoritetit të Mbrojtjes së të Dhënave në Madrid, Spanjë. Në këtë vizitë e rëndësishme ishte njohja me veprimtarinë dhe eksperiencën e këtyre autoriteteve në fushën e mbrojtjes së të dhënave. Vizita studimore ka synuar edhe përgatitjen e një raporti konkret për eksperiencën e marrë dhe risitë që mund të sjellë në të ardhmen.

Në kuadër të Projektit IPA 2009 *“Forcimi i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri për harmonizimin me Standardet e Bashkimit Evropian”*, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale së bashku me FIIAPP-PROGECO, kompaninë implementuese të këtij projekti të financuar nga BE, ka organizuar në datën 13 Dhjetor 2011, **Work**-shopin e titulluar *“Përpunimi i të Dhënave Personale në Sektorin e Zbatimit të Ligjit”*. Të ftuar si pjesëmarrës në këtë aktivitet të rëndësishëm kanë qenë përfaqësues të ministrive të ndryshme si: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integritetit, MITIK etj. Gjithashtu të ftuar kanë qenë edhe përfaqësues të fushës së zbatimit të ligjit si organi i Prokurorisë dhe Policia e Shtetit nga rrethet e ndryshme të vendit.

Po ashtu në këtë work-shop kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të autoriteteve mbikëqyrëse të mbrojtjes së të dhënave personale të rajonit si nga Republika e Kosovës dhe Republika e Malit të Zi.

Në hapjen e këtij aktiviteti mbajtën fjalën e tyre Znj. Flora Çabej (Pogaçe), Komisionere për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Z. Clive Rumbold, Kreu i Seksionit Politik, Ekonomik dhe Informacionit në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, Z. Hysni Burgaj, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe Z. Sokol Stojani, Drejtor i Hetimit dhe i Kontrollit, në Prokurorinë e Përgjithshme. Gjatë këtij work-shopi u trajtuan disa tema të ndryshme nga Z. Emilio Aced Felez, Zv/Drejtor i Autoritetit të Komunitetit të Madridit për Mbrojtjen e të Dhënave, ish-kryetar i Organit të Përbashkët Mbikëqyrës të Europolit si dhe ka qenë përfaqësues i Komisionerit Spanjoll për mbrojtjen e të dhënave në grupe pune në nivel Bashkimi Evropian dhe Këshillit të Evropës. Ai trajtoi tema si : *“Aplikimi i Parimeve të Mbrojtjes së të Dhënave në Sektorin e Zbatimit të Ligjit”*, *“Përpunimi i të Dhënave Personale në BE në Kuadrin e Bashkëpunimit të Sektorit Gjyqësor me Policinë Autoritetet e përbashkëta Mbikëqyrëse”* si dhe tema *“Kërkesat Ligjore për Përpunimin e të Dhënave Personale në Sektorin Shqiptar të Zbatimit të Ligjit”* referuar nga përfaqësues të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Aktiviteti u mbyll nga Z. Emilio Aced Felez, i cili prezantoi *“Projekt - Udhëzimin për Periudhën e Ruajtjes së të Dhënave Personale në Arkivat e Policisë së Shtetit Shqiptar”*. Të pranishmëve në këtë aktivitet, iu shpërndanë edhe materiale të ndryshme sensibilizuese nga fusha e mbrojtjes së të dhënave personale.



Bashkëpunimi me projektin është karakterizuar nga një numër i konsiderueshëm trajnimesh në të cilët janë trajtuar tema nga më të rëndësishmet e të djeshmet në vend duke përfshirë në to përfaqësues të instricioneve të ndryshme me synim aftësimin profesional të tyre sipas specifikave të fushave ku ushtrojnë detyrat përkatëse. Organizimet kanë pajisur pjesëmarrësit me dije edhe mbi çështje praktike si dhe kanë pajisur ata me certifikatat në pasurim të kurikulës së tyre. Në mënyrë intensive në të gjithë trajnimet, përgatitjet e dokumentave ligjorë, konsulencat reciproke, autoriteti është asistuar nga ekspertë të huaj të fushave konkrete. Nëpërmjet projektit është mundësuar që në të gjithë trajnimet të lançohen draftet e përgatitura për të marrë një opinion të gjerë përpara miratimit e vënies në zbatim të tyre. Projekti ndër konponentët kryesorë ka fokusuar zhvillimin e kuadrit ligjor dhe për këtë për tu njohur me punën, zbatimin praktik të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, etj ka organizuar edhe vizita studimore në vende të tjera të avancuara në këtë drejtim. Intensivisht projekti ka trajnuar edhe stafin e autoritetit nëpërmjet referimeve të ekspertëve, kryesisht mbi kërkesat e vetë stafit në çështje të transferimit ndërkombëtar, masave të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale, etj.

Më konkretisht evidentojmë temat e prezantuara në këto trajnime:

“Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale”

“Siguria e të Dhënave Personale”.

"Siguria e informacionit, auditimi i sistemeve të TI, menaxhimi i riskut operacional, vazhdimësia e biznesit & planifikimi i riparimit të dëmtimeve "

“Manualin – Hetimi administrativ i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”

“Mbrojtja e të Dhënave në Agjencitë e Zbatimit të Ligjit”

“Grupin e Punës Artikulli 29 – përkufizimi i miratimit”

“Mbi disa çështje të Mbrojtjes së të Dhënave në lidhje me E-Government”

“Për trajtimin e rasteve konkrete "

“Teknikat e të Folurit ne Publik”

“Roli i Autoritetit për mbrojtjen e të dhënave në përgatitjen dhe organizimin e censusit "

“Kontraktimin e palëve të treta për operacionet me të dhënat personale "

“Përpunimin e të Dhënave në Sektorin e Policisë”

“Mbajtjen e ligjëratave në publik” si dhe

“Mbi “Menaxhimin e Personelit”

Specialistë IT por jo vetëm janë trajnuar edhe në kuadër të projektit EURALIUS së bashku me të gjithë ekspertët IT të Gjykatave në Shqipëri. Në organizime të tilla është diskutuar mbi problemet e hasura gjatë administrimit të sistemit të të dhënave nëpër gjykata dhe gjithashtu është referuar edhe mbi Legjislacionin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Shqipëri në raport me përdorimin e sistemit të të dhënave në Gjykata (ICMIS), mbo përdorimin e masave të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave gjatë përpunimit të tyre, etj.

VII. AKTIVITETE TË TJERA TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

VII.I AKTIVITETE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Dita Evropiane e Mbrojtjes së të Dhënave Personale është shfrytëzuar si një datë e cila do të tërheqë vëmendjen e publikut të gjerë mbi fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Kështu, më datë 26 Janar 2011 Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi një aktivitet ndërgjegjësuës me studentët e vitit të dytë të gazetarisë të Universitetit të Tiranës. Gjatë këtij aktiviteti, studentët e gazetarisë u njohën me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe misionin e saj si edhe me aktet nënligjore të miratuara nga Komisioneri siç janë udhëzimi për “Përpunimin e të Dhënave Personale në fushën e Arsimit” si dhe udhëzimi për “Median e shkruar dhe audiovizive”.

Në datën 28 Janar 2011, pikërisht në Ditën Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Zyra e Komisionerit organizoi një takim me nxënësit e shkollës Dora d’Istria në Tiranë. Meqenëse nxënësit e këtyre moshave janë përdorues të rregullt të rrjeteve sociale, për pasojë edhe mundësia e përhapjes pa kriter të të dhënave personale është e lartë. Për të mund të evituar këtë fenomen, është parë e nevojshme që nxënësit të ndërgjegjësohen mbi fushën e gjerë të mbrojtjes së të dhënave personale si dhe nga efektet anësore që mund të ketë përdorimi i këtyre rrjeteve sociale. Nga ana e punonjësve të Zyrës së Komisionerit u mbajtën disa prezantime mbi këto tema dhe më pas u bashkëbisedua me nxënësit për çështje të cilat ata vetë i konsideronin si të paqarta. Gjithashtu u shpërndanë edhe një set broshurash të pregatitura nga stafi i Zyrës së Komisionerit në të cilat përfshiheshin edhe këshilla për prindërit dhe mësuesit. Gjatë këtij takimi, u ofrua edhe plotësimi i një pyetësoi të përgatitur nga ana e Zyrës së Komisionerit, për të vlerësuar shkallën e përdorimit të rrjeteve sociale dhe njohjen e politikave të privatësisë gjatë përdorimit të tyre nga ana e kësaj grupmoshe.

Pikërisht në datën 11 Shkurt 2011, në kuadër të veprimtarive për informimin e publikut të gjerë mbi fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Privatësisë, Zyra e Komisionerit organizoi një aktivitet sensibilizues, pranë Qendrës Tregtare “ETC” në Tiranë. Në këtë aktivitet, Zyra e Komisionerit mori kontakt të drejtëpërdrejtë me publikun si subjekte të të dhënave, duke realizuar shpërndarjen e fletëpalosjeve të ndryshme si, udhëzuesi për përdorimin e rrjeteve sociale online, broshura informuese mbi fushën e gjerë të mbrojtjes së të dhënave personale dhe të drejtën për privatësi të individëve, etj. Aktiviteti pati një kohëzgjatje të konsiderueshme duke vlerësuar dhe

fluksin e vazhdueshëm të publikut të pranishëm në këtë qendër tregtare. Vlen për t'u përmendur interesi i publikut për t'u njohur në veçanti me të drejtën e tyre për privatësi e garantuar kjo në ligjin Nr.9887 dt 10.03.2008 për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe mundësinë për t'iu drejtuar Zyrës së Komisionerit për t'u ankuar në lidhje me përpunimin e paligjshëm të të dhënave të tyre personale.

Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi një takim ndërgjegjësues me nxënës të klasave të teta dhe të nënta të shkollës 9 – vjeçare “Sabaudin Gabrani” në qytetin e Tiranës. Aktiviteti kishte për synim ndërgjegjësimin e kësaj grupmoshe në lidhje me rreziqet e shkeljes së privatësisë të cilat mund të vijnë nga ekspozimi i pakujdesshëm në internet e veçanërisht gjatë përdorimit të rrjeteve sociale. Aktiviteti pati një kohëzgjatje prej 45 minutash dhe zgjoi interesin e nxënësve të cilët ishin të interesuar të njiheshin në detaj me rreziqet e shkeljes së jetës private gjatë përdorimit të rrjeteve sociale, emailit apo dhe lundrimit në Internet. Pyetjeve të shumta të nxënësve iu përgjigjën specialistët e Zyrës së Komisionerit si dhe specialisti i IT-së i cili solli raste konkrete të mundësive të shkeljes së privatësisë në Internet. Gjatë këtij takimi u shpërndanë edhe një set broshurash të pregatitura nga stafi i Zyrës së Komisionerit në të cilat përfshiheshin edhe këshilla për prindërit dhe mësuesit. Këto fletëpalosje janë të ideuara nga Zyra e Komisionerit dhe kanë titujt përkatës: “Mbrojtja e të Dhënave Personale, Ku qëndron problem ?”, si dhe “Udhëzues për përdorimin e Rrjeteve Sociale online“. Falë bashkëpunimit me Drejtorinë Arsimore të Rrethit Tiranë, është bërë i mundur ekspozimi i këtyre fletëpalosjeve në stendat e vendosura në ambientet në hyrje të shkollave me qëllim ndërgjegjësimin e sa më shumë nxënësve.

Në datën 10 Qershor 2011, në kuadrin e vazhdimin të ndërgjegjësimin, e veçanërisht të studentëve shqiptarë në lidhje me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun organizoi një seminar sensibilizues me studentët e Universitetit “Luigj Gurakuqi” në qytetin e Shkodrës. Në seminar u referuan tema të ndryshme nga drejtues dhe specialistë të Zyrës së Komisionerit si: “Parimet e Mbrojtjes së të Dhënave Personale”, “Autoriteti Mbikëqyrës Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe raste praktike nga fusha e mbrojtjes së të dhënave personale”, “Privatësia në kohën e Internetit” si dhe “Siguria e Informacionit”. Seminari pati një kohëzgjatje prej rreth dy orësh dhe u ndoq me interes nga studentët e Universitetit “Luigj Gurakuqi” të cilët kryesisht ishin studentë të Fakultetit Juridik. Aktiviteti u organizua me mbështetjen e Rektoratit të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, në ambientet e Bibliotekës Shkencore të këtij universiteti. Gjithashtu gjatë këtij aktiviteti u shpërndanë edhe fletëpalosje sensibilizuese si: “Njohja me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, “Banking Online”, “Kujdes nga efektet anësore gjatë përdorimit të rrjeteve sociale” etj.

VII.II EKSPOZE E PUNËS SË KRYER NGA SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT GJATË VITIT 2011.

Gjatë vitit 2011 Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit është angazhuar në veprimtari të ndryshme në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës së pajisjeve, sistemeve dhe komunikimeve elektronike, përditësimin e punonjësve me zhvillimet dhe rreziqet në fushën e teknologjisë dhe informacionit, trajnime, inspektime etj.

Gjatë vitit kalendarik 2011, Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit bazuar edhe në parashikimin e programit vjetor për të njëjtin vit, ka realizuar administrimin e pajisjeve dhe sistemeve të komunikimeve elektronike. Periodikisht janë bërë kontrole teknike për mirëfunksionimin e tyre.

Është bërë analiza e fluksit të punës në Institucion dhe janë përgatitur termat e referencës për aplikacionin *“sistemi informatikë i menaxhimit të të dhënave (protokoll dhe komunikime elektronike)”*. Qëllimi i këtij sistemi është të regjistrojë dhe protokollojë në mënyrë elektronike të dhënat dhe dokumentacionin hyrës/dalës në Institucion, delegimin e dokumentit sipas hierarkisë apo nevojës për trajtim, kthimin e përgjigjeve, rikthim për shqyrtim etj.

Është instaluar sistemi i kontrollit të aksesit i cili regjistron hyrjet dhe daljet e punonjësve në ambientet e Institucionit, si dhe sistemi *“centrali telefonik i brendshëm”* instalimi i të cilit mundëson komunikim efektiv telefonik në ambientet e Institucionit.

Është vënë në funksionim ambienti i përcaktuar si *“server-room”* ku janë instaluar serverat dhe sistemet e tjera të menaxhueshme nga sektori i Teknologjisë dhe Informacionit. Në këtë ambient kanë akses vetëm punonjësit e autorizuar.

Në faqen zyrtare të Institucionit janë përditësuar të gjitha aktivitetet e organizuara nga zyra e Komisionerit si marrëveshje bashkëpunimi, pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare, seminare të organizuar për kontrollues të të dhënave personale publik dhe privat, publikimin e informacioneve të reja, aktivitete sensibilizuese për subjektet e të dhënave personale, udhëzime të Komisionerit për kontrolluesit e të dhënave personale, legjislacion ndërkombëtar etj.

Është marrë pjesë në inspektimet e organizuara nga Drejtoria e Hetim Inspektimit në kontrolluesit publik dhe privat të të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë. Për çdo inspektim janë bërë rekomandimet përkatëse në lidhje me përdorimin e pajisjeve të teknologjive të informacionit, masat e sigurisë për aksesin në të dhëna personale, hartimin e rregulloreve dhe politikave të sigurisë etj.

Është marrë pjesë në seminarët e realizuar në funksion të kontrolluesve, përpunuesve dhe subjekteve të të dhënave personale. Janë bërë referime në lidhje me teknologjitë e informacionit me të cilat subjektet e të dhënave personale apo kontrolluesit e të dhënave personale përballen në jetë dhe në punën e përditshme. Temat në lidhje me përdorimin e teknologjive të informacionit kanë qenë objekt diskutimesh sidomos tek të rinjtë, si shtresa e shoqërisë më tepër e lidhur me përdorimin e këtyre teknologjive.

Është marrë pjesë në trajnimin e Administratës Publike në lidhje me *“Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* në veprimtaritë përkatëse të organizuar nga ITAP.

Në kuadër të projektit *“Për forcimin e zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri”*, është marrë pjesë në vizitën studimore në *“Agjencinë Kombëtare Spanjolle të Mbrojtjes së të Dhënave Personale”* si dhe *“Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Madridit”* në Spanjë. Në takimet dhe diskutimet e kryera në këto Institucione u përfitua eksperiencë në lidhje me zhvillimin e kontroleve administrative dhe të rejat e fundit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në komunikimet elektronike.

Në kuadër të bashkëpunimit ndër-Institucional për rritjen e aftësive profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit në parandalimin dhe përgjigjen ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike, AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) organizoi një trajnim për specialistët e teknologjisë dhe informacionit me temë: “*Resilience Management Model*” (Modeli Elastik i Menaxhimit). Trajnimi u referua nga ekspertë të Institutit të Inxhinierisë Softëare (SEI) të Universitetit “*Carnegie Mellon*” në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ishte i pari në kuadrin e Programit për Sigurinë Kibernetike të AKSHI-it.

VII.III PERFORMANCA FINANCIARE.

Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale ka realizuar menaxhimin e burimeve në përputhje me kërkesat e procedurat e Ligjit nr.8549, date 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", ka programuar dhe zhvilluar kapacitetet njerëzore nëpërmjet trajnimeve duke shfrytëzuar të gjitha burimet, të brendshme, të jashtme si trajnimet pranë ITAP, KSHC, OSBE si dhe përfitimet nga mbështetja e projektit IPA 2009, nëpërmjet projektit FIIAPP “Mbështetje dhe fuqizimi i zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave personale”.

Mbulimi i veprimtarisë financiare të KMDP-së është synuar e arritur nëpërmjet përdorimit me efektivitet, ekonomi dhe eficensë të fondeve buxhetore.

Rekrutimi

- Gjatë vitit 2011, janë ndjekur të gjitha etapat për rekrutimin e punonjësve, në zbatim të Ligjit nr.8549, date 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”, duke filluar nga kërkesat dhe shpallja e vendeve të lira të punës dhe më tej me procedurat e testimit dhe emërimit.
- Është ndjekur gjithashtu procedura e lëvizjes paralele për rritjen forcimin dhe efektivitetin e punës së drejtorive përkatëse.

Motivimi

- Në zbatim të Strategjisë mbi zhvillimin dhe motivimin e punonjësve, janë ndjekur procedurat për miratimin e shkallës së vëshirësise, për punë të vështirë dhe të dëmshme për shëndetin, për pozicionet e punës së punonjësve mbështetës, në zbatim të V.K.M-së Nr.717, datë 23/09/2009 “Për pagat e punonjësve mbështetëse të institucioneve Buxhetore e nëpunësve të disa institucioneve Buxhetore”, sipas normave dhe përqindjes së miratuar .
- Gjithashtu, gjatë këtij viti është marrë konfirmimi i shtesës mbi page për pozicionet e Specilastit të IT referuar V.K.M 545, date 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe pagave të nëpunësve Civile në administratën shtetërore”.

Vlerësimi

- Është kryer vlerësimi vjetor individual (formularët të vlerësimit) për vitin 2011, por shpërblimet nuk janë zbatuar si rezultat i VKM Nr.472, datë 02.07.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, pika 1/b e c.

Zhvillimi i Kapaciteteve

- Në kuadër të fuqizimit të autoritetit të Komisionerit, prioriteteve të vendosura për vitin 2011, strategjisë së miratuar për vitin 2011-2012 shoqëruar dhe me planin e trajnimeve për vitin 2011, zhvillimit të kapaciteteve të stafit të zyrës, rritjes së aftësive profesionale dhe përmirësimit të njohurive bazë, në mënyre që çdo punonjës të kontribuojë me optimalitet në arritjen e qëllimit dhe objektivave të vendosura për tu realizuar, janë mbajtur kontakte të rregullta me ITAPI-in për të marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga ky i fundit.
- Në vijim të përmbushjes së këtij prioriteti theksojmë bashkëpunimin e frytshëm me Projekti EU IPA- 2009, FIAPP në drejtim të forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore. Është përgatitur raporti nga ekspertet e projektit për burimet njerëzore lidhur me metodologjinë e analizës së nevojave për trajnim, përcaktimin e nevojave për trajnim në KMDP për të gjitha nivelet e shkallës hierarkike strukturore si dhe plani i trajnimeve për vitin 2011, i cili është miratuar në shtator 2011.
Në zbatim të tij, institucioni ynë është përfshirë në projektet e ITAPI-it, me pjesëmarrje të stafit të zyrës së Komisionerit sipas moduleve të paraqitura nga ITAP-i dhe nevojave të institucionit. Pjesëmarrësit janë pajisur dhe me dëshmitë përkatëse të ndjekjes së programeve të trajnimit dhe përfitimit të njohurive.
- Në kuadër të projektit IPA 2009, ku një nga komponentët e tij ka qenë dhe trajnimi i stafit, marrja e eksperiencës nga vendet e BE dhe implementimi i tyre në institucionin tonë, ka mundësuar trajnimin e të gjithë stafit sipas specifikave të tyre me ekspertë të huaj të fushave përkatëse si në ambientet e institucionit ashtu dhe me pjesëmarrje në vendet e BE-së.
- Gjithashtu, është marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave lidhur me ndjekjen dhe pajisjen me dëshminë e “Auditit të Brendshëm në sektorin publik” për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm .
- Është ndjekur kursi 2-javor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, nga drejtoria që mbulon këtë fushë për zbatimin e Ligjit “Mbi arkivat” shoqëruar me certifikatat përkatëse.
- Sigurisht nuk janë ndërmarre pjesëmarrje në trajnime jashtë vendit, me fondet buxhetore, për rritjen e efektivitetit të cilësisë së kapaciteteve të burimeve njerëzore, pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 472 datë 02.07.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore” .
- Krahas pjesëmarrjes në trajnimet brenda vendit, apo në organizimet dhe pjesëmarrjet në konferenca dhe takime periodike ndërkombëtare jashtë vendit, strukturat përgjegjëse në KMDP, rëndësi të veçantë i kanë kushtuar përkthimit, shpërndarjes dhe përvetësimit të materialeve të siguruara në këto seminarë, konferenca, takime, etj. Madje pjesa dërmuese e këtyre materialeve janë hedhur në CD në formën e një epërmbledhëse të mirëevidentuar, së bashku me raporte dhe informacione të tjera të ndryshme nga institucionet dhe organizmat homologe dhe janë vënë në dispozicion të të gjithë Drejtorive përkatëse. Gjithashtu është bërë praktikë pune në institucion, hedhja në rrjetin e brendshëm “Intranet” e një pjesë të konsiderueshme të këtyre materialeve. Këto mënyra përdorimi kanë gjetur efikasitet në punën dhe realizimin e detyrave tona në kohë e me profesionalizëm.

Përmirësimi në menaxhimin e fondeve publike nëpërmjet planifikimit dhe përdorimit të tyre me efikasitet, dobi dhe efektivitet.

Gjatë procesit të planifikimit dhe realizimit të buxhetit të vitit 2011, KMDP ka ndjekur dhe zbatuar me përpikmëri kërkesat e ligjit organik të saj, të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe udhëzimeve në zbatim të tij, Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjit nr.10355, datë 02.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2011”.

Planifikimi

Gjatë periudhës së analizuar për vitin 2011 janë:

- Realizuar e detajuar fondet buxhetore, të akorduara nga Ministria e Financave për vitin 2011 në artikujt për paga, sigurime shoqërore, shpenzime për mallra e shërbime dhe investime. (në nivel vjetor e mujor)

Ky detajim u bë në përputhje me Ligjin nr.10355 datë 02.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, Udhëzimin nr.4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2011”.

- Përsa i përket kontabilitetit, ai është organizuar dhe mbajtur konformë kërkesave të Ligjit nr.7661, datë 19.01.1993 “Për kontabilitetin” dhe planin e përgjithshëm, përfshirë Ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.
- Përgatitja, rakordimi i llogarive vjetore si dhe plotësimi i pasqyrave financiare me anekset përkatëse mbi gjendjen e aseteve fikse e qarkulluese dhe gjendjen financiare në fund të vitit 2010, janë dorëzuar në zbatim të ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi, brenda afateve kohore të përcaktuara në to.
- Në zbatim të kriterëve të parashikuara në legjislacionet e mësipërme dhe bazuar në strategjinë dhe objektivat e saj janë hartuar dhe dërguar pranë Ministrisë së Financave, kërkesat Buxhetore, të detajuara, të projekt-Buxhetit afat-mesëm 2012-2014, për programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, sipas formateve standarde, në zbatim të udhëzimit nr.8, datë 02/03/2011 “Për përgatitjen e Buxhetit të shtetit dhe fondeve Speciale”, brenda afateve të përcaktuara në të (datë 30 prill). Është vijuar me fazën e dytë të projekt Buxhetit, plotësimin e pasqyrave mbi shpenzimet buxhetore që parashikohen të realizohen për vitin 2012 dhe dy vitet e mëpasëshme.
- Është mbrojtur buxheti pranë Komisionit të Ligjeve në Nëntor 2011, ku dhe rezultoi me përfitim shtesë në dy zërat kryesore; 602 “Mallra e shërbime” si dhe në Investime në masën 2.000 në mijë lekë, fonde mjaft të domosdoshme për të realizuar objektivat e vitit 2012.
- Janë planifikuar dhe realizuar transferimet e fondeve në zërat e kërkuara, për paga personeli e buxhete familjare, për organizime e aktivitete sociale-kulturore si dhe ndjekja dhe realizimi i tyre.

- Është bashkëpunuar me Drejtoritë në lidhje me planifikimin e nevojave për mbështetje financiare në funksion të përmbushjes së misionit të njësisë organizative dhe objektivave operacionale.

Zbatimi i Buxhetit

- Ngritja e grupeve të punës dhe komisioneve lidhur me zbatimin e procedurave standarde të blerjeve apo dhe marrjes në dorëzim dhe kolaudit të mallrave e shërbimeve, objekt prokurimi .
- Ndjekja e realizimit të procedurave të prokurimeve në mbështetje të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, udhëzimit nr.2, datë 18.02.2008 ”Për procedurën e blerjeve të vogla” si dhe Procedurave me tenderim mbi bazën e kërkesave dhe fondeve të alokuara sipas projekteve të miratuara nga Ministria e Financave.
- Gjate vitit 2011, si rezultat i rishimit të buxhetit në masën 1.800 në mijë leke, u ndërmorën masa lidhur me shkurtimin e shpenzimeve operative e kryesisht të shpenzimeve të telefonisë fikse e celulare, shpenzimeve postare etj.

Një paraqitje më e detajuar jepet në vijim.

Për vitin 2011 në zbatim të ligjit nr.10355, datë 02.12.2010 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2011” i ndryshuar, është miratuar fondi sipas tabelës dhe zërave të shpenzimeve të mëposhtme:

Transferimet, ndryshimet e realizimet:

000 / lekë

Nr	EMERTIMI	PLAN	% kundrejt totalit	Rishikim i buxhetit	Fakt 12 mujor	% realizimi kundrejt planit vjetor
1	Paga	27.265	59	27.265	25.700	94 %
2	Sigurime shoqërore	4.200	9	4.200	3.872	93%
3	Mallra e shërbime të tjera	9.949	22	8.149	7.966	98%
4	Investime	4.000	8	4.000	3.950	99%
5	Transferta të buxhetit familjare	455	0.09	455	455	100 %
6	Kuotizacion	30	0.0006	30	29	97%
	Totali	45.900	100	44.100	41.972	95

- Fondi i akorduar nga Buxheti i shtetit për paga dhe sigurime shoqërore në përputhje me kërkesën për të mbuluar nevojën e institucionit, sipas strukturës organike me 29 punonjës. Mos realizimi në masën 7 % ka ardhur si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante, për rrjedhojë të dështimit të procedurave të herëpashershme të konkurimit për të njëjtin pozicion pune. Gjithashtu, mosrealizimi ka ardhur dhe si rezultat i ndërprerjes së procedurave të konkurimit në zbatim të V.K.M nr 472, datë 02.07.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve

buxhetore”. Më pas me shfuqizimin e ngrirjes së vendeve vakante kanë vijuar procedurat e rekrutimit.

- Arsyeja e dytë vjen si rezultat i mospërdorimit të fondit të veçante për shpërblim për rezultate në punë, referuar formularëve dhe vlerësimeve vjetore të personelit.
- Në realizimin e shpenzimeve operative “Mallra e shërbime” në masën 98 % , KMDP është mbështetur në një shpërndarje dhe rishpërndarje të fondeve buxhetore, referuar kërkesave për mbështetje financiare, në permbushje të planit strategjik, objektivave, aktiviteteve prioritare, për një menaxhim me efektivitet të fondeve të akorduara, nëpërmjet plotësimit të dokumentacionit ligjor për likuidim, vendosjes së sistemeve të kontrollit dhe zbatimit të procedurave standarde operacionale. Janë likuiduar në kohë të gjitha detyrimet ndaj të tretëve, si për blerjet dhe për shërbimet e parashikuara për vitin 2011.
- Në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, në mbështetje të Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” me ndryshimet përkatëse, VKM nr.135, date 03.02.2008 dhe nr .392, datë 8.04.2008 si dhe të planifikimit në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike, për vitin 2011, realizimi i shpenzimeve për krijimin e aktiviteteve është në masën 99 %. Gjatë vitit 2011 është ndjekur 1 procedure tenderimi me objekt “Sistem Informatik i Menaxhimit të të dhënave të institucionit” i cili mundëson informatizimin e procedurave administrative të zyrës, dixhitalizimin e protokoll-arkivës si dhe krijimin e arkivës elektronike për vendimet, udhëzimet, inspektimet dhe çdo dokument hyrës apo dalës, të ndarë sipas shkallës hierarkike të vendimarrjes.
- Me procedurën me “Blerje të vogla” sipas projekteve të miratuara nga Ministria e Financave për vitin 2011, janë ndjekur proceset standarde, për krijimin e aktiviteteve të reja të institucionit, në kuadër të plotësimit optimal të kushteve të punës si dhe mirëfunksionimit të brendshëm të tij. Konkretisht janë realizuar blerje me objekt:
 - Instalimi i centralit të brendshëm telefonik;
 - Ndërtimi i rrjetit të brendshëm kompjuterik;
 - Instalimi i sistemit të akses-kontrollit me karta;
 - Mobilime të zyrave;
 - Pajisjeve kompjuterike;
 - Pajisje të tjera zyre;
 - Pajisje kondicionimi.

Monitorimi

Janë paraqitur në Ministrinë e Financave dhe njësisë të saj vartëse, brenda afateve të caktuara:

- Realizimi i investimeve për KMDP / Drejtoria e Buxhetit, Dega e thesarit.
- Realizimi i fondeve buxhetore korrente, për KMDP /Drejtoria e Thesarit, çdo muaj.
- Realizimi i fondeve buxhetore korrente, për KMDP / Drejtoria e Buxhetit, çdo 3/mujor si dhe në faqen e Webit në postin Raportime, janë shfaqur dhe bërë publike raportet e monitorimit të shpenzimeve buxhetore, me struktura të veçantë në lekë dhe në produkte.
- Hartimi dhe dërgimi i aktiviteteve , produkteve që do të realizohen dhe monitorohen gjatë vitit 2011 pranë Ministrisë së Financave, në zbatim të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

- Hartimi dhe Dërgimi i Raportit të hollësishëm, vjetor, pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, mbi prokurimet publike e procedurat e ndjekura nga KMDP, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike “dhe të dispozitave ligjore financiare në fuqi të Prokurimeve Publike për vitin 2010 si dhe janë dërguar raporte periodike, çdo 4-mujor, mbi realizimin e fondeve dhe procedurave për vitin 2011.

VII.IV TRAJNIME TË VAZHDUESHME ME ITAP.

- Tanimë ka nisur edhe trajnimi nga ITAP, ku ndër të tjerë marrin pjesë edhe nëpunës të stafit të KMDP-së. Në këtë kuadër, në trajnimin e zhvilluar me temë “Menaxhimi i Kontratave”, është trajnuar një specialist i drejtorisë së çështjeve procedurale ligjore.
- Gjatë muajit dhjetor, KMDP ka qenë pjesëmarrëse në seminare, organizuar nga Agjencia e Prokurimit Publik lidhur me procedurat e prokurimit publik; seminarin trajnues të organizuar nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike me temë “**Menaxhimi i Financave Publike, Cikli i PBA-së dhe prokurimi**”, “Menaxhimi i kontratave” dhe “Menaxhimi i Sistemit të Planifikimit të Integruar”.
- Ndërsa në kuadër të bashkëpunimit me ITAP është mundësuar edhe roli i Komisionerit në cilësinë e trajnerit për tema të ndryshme në mbrojtje të të dhënave personale të subjekteve të ndjekura me mjaft interes nga pjesëmarrës të institucioneve të ndryshme shtetërore.


VIII. STRATEGJIA INSTITUCIONALE 2012-2013

Si një dokument mjaft i rëndësishëm dhe impenjativ për tu arritur, strategjia institucionale synon:

- miratimin e amendamenteve ligjore të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale;
- zhvillimin e vazhdueshëm të kuadrit ligjor të brendshëm duke synuar praktikën më të mira ndërkombëtare;
- të tjera marrëveshje bashkëpunimi;
- bashkëpunimin e ngushtë me projektin IPA-2009 për të arritur nivel të lartë profesional në punën tonë të përditëshme;
- trajnimin e kontrolluesve në sektorët e medias, avokatisë, noterisë, prokurorisë, shëndetësisë, etj;
- rritjen e ndërgjegjësimit të mbarë publikut mbi mbrojtjen e privatësisë së tyre kryesisht në kushtet e një zhvillimi të vrullshëm teknologjik;
- progres në kryerjen e inspektimeve;
- sanksione pa hezitim në rastet e shkeljes së ligjit;
- punë intensive, gjetja e të gjithë hapësirave për të komunikuar drejtëpërdrejtë me kontrolluesit dhe për ta intensifikuar këtë komunikim me rrugë postare apo postë elektronike për të rritur numrin e njoftimeve ;
- bashkëpunim të frytshëm ndërkombëtar, etj.

IX. TË DHËNA STATISTIKORE PËR RAPORTIN 2011

- Ankesa, Inspektive dhe Gjoha, krahasim i vitit 2010 dhe 2011.




- Inspektive dhe Gjoha në sektorët publikë dhe privatë për vitin 2011.





- Rastet në lidhje me përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale në 2011 (të dala gjatë inspektimeve) - një krahasim ndërmjet publikut dhe sektorit privat.

	Spektori publik	Spektori privat
 Video survejim i paligjshëm	5	10
 Siguria dhe konfidencialiteti	15	19
 Përpunim joproporcional	2	15
 Publikimi i paligjshëm	1	1
 Të dhëna sensitive	0	4
 Koha e mbajtjes së të dhënave	0	4
 Detyrimi për të njoftuar	8	14
 Marrja e pëlqimit	0	3
 Detyrimi për t'u informuar	1	8
 Marketing i drejtpërdrejtë i paligjshëm	0	3
 Transferim ndërkombëtarë	1	0


- Rastet më të zakonshme në shkeljet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale për vitin 2011(të dala gjatë inspektimeve).



- Rregullimi ligjor për vitin 2011.




- Numri i kërkesave për autorizim të transferimit të të dhënave personale në vite.




- Vizitorët, numri i vizitave dhe nr total i faqeve të vizituara gjatë 6- mujorit të dytë 2010

Gjashtë mujori i II_të 2010	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	TOTAL
Vizitorë unik	6	624	552	536	759	717	3194
Nr. i vizitave	13	3570	3036	2296	2910	2829	14654
Nr. Total I faqeve të vizituara	333	7182	6799	7229	9581	9234	40358




- Vizitorët, numri i vizitave dhe nr total i faqeve të vizituara gjatë vitit 2011.

Viti 2011	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Vizitorë unik	745	809	776	776	679	646	529	336	512	706	535	481	7530
Nr. i vizitave	3003	2435	1934	1741	1636	1477	1409	953	1469	1823	1483	30789	50152
Nr. Total i faqeve të vizituara	9163	9230	5258	5945	4800	4306	3250	1633	3647	6012	3821	33075	90140




Seminare të organizuara me kontrollues




- Të dhëna statistikore, krahasim nga viti 2009-2011 mbi regjistrimet dhe njoftimet e kontrolluesve në Republikën e Shqipërisë.

	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011
Njoftime	37	1199	1038
Regjistrime	30	1012	871

Njoftime



Regjistrime




- Sensibilizimi dhe njohja me ligjin nr. 9887 për “Mbrotjtjen e të dhënave Personale” per vitin 2011.



- Njoftime të përgjithshme për vitin 2011, sipas subjektit.

	Institucione publike				Institucione private	Organizate Jo-fitimprurese
	Institucion e qendrore	Institucione të Pushtetit Vendor		Institucione të tjera		
	Ministri te linjes	Komuna	Prefektura			
Njotime	3	35	3	177	773	47
TOTALI	218				773	47
	Gjithsej 1038 kontrollues					


	Përqindja e njoftimeve
Institucione publike	218
Institucione private	773
O.J.F.	47



- Subjektet e regjistruara sipas fushave.


	FUSHAT															
	Arsimi	Shendetesia					Tregtia				Sherbime Ligjore		Teleko munik acion	Të tjera		
	Universitete	Spitale	Klinika	Qendra Shendetesore	Drejtoria e sherbimit spitalor	Farmaceutik	Shoqeri Tregtare	Sherbime Marketingu	Ndertim	Menaxhim i Prones	Transport	Studio Ligjore	Avokati	Noteri	Komunikimi Elektronik	Kontrollues të fushave të tjera

Subjekte -t e regjistru -ara	3	3	4	10	8	11	4	2	3	1	4	3	3	2	1	809
Total	3	36					14					8			1	809
	871															



- Tabela e menaxhimit të procesit të njoftim-regjistrimit

Numri i shkresave	Sektori publik	Sektori privat
	417	5169
TOTALI	5586	



LLOJI I AKTIVITETIT	Nr.
Informacion plotesues të kërkuar	1027
Informacion i plotë të ardhura me shkresa, e-maile, tel.	561
Telefonata për sqarim	1664
Pritje të subjekteve për sqarim	445
Raste që kemi kërkuar që subjekti të paraqesi kërkesë për transferim ndërkombëtar në vende pa nivel	2
Raste te dyshuara per cenim te privatesise dhe te dhenave personale-informacion per Drejtorine e Hetim-Inspektimit per verifikim dhe procedura te tjera ligjore	13
TOTALI	3699

